



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 759 Akti

Nr. 777 Vendimi
Tiranë, më 25.6.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Firdes Shuli	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datën 24.6.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Saimir Nazifi**, me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Saimir Nazifi, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Saimir Nazifi është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të tij si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.6.2021, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Etleda Çiftja dhe Firdes Shuli (relatore). Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, nga Komisioni janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues komisionerin Lulzim Hamitaj dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Me vendimin nr. 2, datë 28.5.2024, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Saimir Nazifi; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 e 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 29.5.2024, përmes postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 10.6.2024; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 29.5.2024, subjekti i rivlerësimit ka marrë kopje të akteve të dosjes.

8. Në datën 24.6.2024, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

9. Në datën 25.6.2024 u shpall vendimi për subjektin e rivlerësimit Saimir Nazifi.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

11. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

13. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

VLERËSIMI I PASURISË

14. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, i cili ushtron detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë *Vetting* në datën 30.1.2017, me nr. indeksi ***.

15. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Saimir Nazifi ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 30.4.2018, në të cilin ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarim pasurie ndër vite; (ii) ka mungesë burimesh financiare dhe dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

16. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Saimir Nazifi.

17. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

18. *Automjet tip “Opel Astra”, prodhim i vitit 2003, me targë ***, blerë në vlerën 5,500 euro, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2011¹. Për blerjen e kësaj makine janë përdorur të ardhurat nga shitja e pronës, konkretisht e një dhomë (apartament i katit të parë) me sipërfaqe 16 m² (e kthyer më pas në dyqan), ndodhur në qytetin e Peshkopisë. Kjo dhomë u ble për shumën 200,000 lekë, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., dhe është shitur në datën 26.8.2005 për vlerën 1,000,000 lekë, me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol. Zotërues 100%. Burimi i krijimit: nga shitja e pronës në Peshkopi. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.*

18.1. Në lidhje me këtë automjet ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2011, blerësi Saimir Nazifi i ka blerë shitësit D. B. automjetin tip “Opel Astra”, vit prodhimi 2003, në vlerën 5,500 euro. Mjeti është regjistruar në DPSHTRR në emër të subjektit. Në DPV-në e vitit 20011, subjekti ka deklaruar se e ka blerë mjetin tip “Opel Astra” në çmimin 5,500 euro në datën 6.10.2011 dhe se burimi i të ardhurave kanë qenë nga paga e tij dhe e bashkëshortes, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se burimi i të ardhurave është nga shitja e pronës që ka pasur në qytetin e Peshkopisë. Në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se këtë mjet e ka shitur në datën 6.9.2019 me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., z. E. D. kundrejt vlerës 1,600 euro, kontratë të cilën e ka vënë në dispozicion të Komisionit.

18.2. Me qëllim verifikimin e të ardhurave nga shitja e pronës së blerë në qytetin e Peshkopisë, bazuar në aktet në dosjen e ILDKPKI-së dhe ato të administruara gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këtë pasuri u kryen verifikimet si vijojnë:

- Sipas aktit noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.2.2003, kundrejt çmimit 200,000 lekë subjekti ka blerë një apartament të përbërë nga një dhomë, ndodhur në lagjen “****” në qytetin e Peshkopisë, me nr. pasurie ***, me sip. 16.2 m², nga shitësit A. H. dhe D. H., dhe çmimi i plotë i shitjes është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës subjekti ka deklaruar blerjen e një apartamenti banimi (një dhomë) ndërtuar përpara vitit 1990, me sip. 10 m², në vlerën 500,000 lekë. Pasi është pyetur për deklarimin e kësaj vlere, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2003 në qytetin e Peshkopisë, ashtu si në të gjithë Shqipërinë, filluan të rriten çmimet e dyqaneve dhe të apartamenteve për shkak të rritjes së kërkesës. Në këto kushte, në DPFN-në e vitit 2003 ka deklaruar çmimin që prezumohej të kishte pasuria në vitin 2003. Nga Komisioni si çmim i paguar është konsideruar vlera sipas kontratës 200,000 lekë.

- Sipas aktit noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.8.2005, Saimir dhe M. Nazifi kanë shitur pasurinë kundrejt çmimit 1,000,000 lekë, deklaruar në DPV-në e vitit 2005.

¹ Në raportin e ILDKPKI-së janë shënuar gabimisht të dhënat e kontratës së shitblerjes së mjetit “nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.6.2009”, pasi duhet të ishte kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2011. Por, duke qenë se vetë subjekti i ka shënuar ato gabimisht në deklaratën *Vetting*, ka vijuar ky gabim.

- Në kartelën e pasurisë janë pasqyruar transaksionet e kryera për këtë pasuri dhe rezulton që në datën 26.8.2005 kjo pronë është regjistruar në emër të shtetasve J. J., M. J. e E. J. dhe është paguar tatimi mbi të ardhurën nga shitja.

- Bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 8.5.2003, të EKB-së, çmimi referencë i shitjes për metër katror në qytetin e Dibrës në vitin 2003 ka qenë në vlerën 22,828 lekë/m², ndaj kjo pasuri do të duhej të ishte blerë nga subjekti në vlerën 369,813.6 lekë (22,828 lekë/m² x 16.2 m²) dhe jo 200,000 lekë sa është vlera e shitjes në kontratën e nënshkruar midis palëve. Bazuar në udhëzimin nr. 5, datë 23.11.2005, të EKB-së, çmimi referencë i shitjes për metër katror në qytetin e Dibrës në vitin 2005 ka qenë në vlerën 23,845 lekë, ndaj kjo pasuri do të duhej të ishte shitur nga subjekti në vlerën 386,289 lekë (23,845 lekë/m² x 16.2 m²) dhe jo 1,000,000 lekë sa është vlera e shitjes në kontratën e nënshkruar midis palëve. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar në mënyrë të paqartë dhe të pavërtetuar se çmimet e njëjshme dhe apartamenteve janë rritur gjatë vitit 2004 (për shkak të rritjes së çmimeve të referencës së DPT-së për efekt të pagesës së tatimit për firmat ndërtuese) dhe prandaj kjo pasuri është shitur në vlerën 1,000,000 lekë.

- Për shkak se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër në periudhën gusht 1996 – prill 2003, Komisioni ka hetuar për ndonjë konflikt të mundshëm interesi që subjekti mund të ketë pasur me shitësin dhe blerësin e pasurisë, nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna.

- Pavarësisht diferencave me çmimet referencë të EKB-së dhe dyshimeve për çmime fiktive, në përfundim të hetimit administrativ janë marrë në konsideratë çmimet sipas kontratave përkatëse.

18.3. Me qëllim verifikimin e të ardhurave që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në qytetin e Peshkopisë në vitin 2003, u konstatua se në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003 subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e punës së tij dhe të prindërve, ndërsa në pyetësin standard subjekti ka deklaruar si burim kursimet në vite të rrogës së tij dhe të bashkëshortes.

Bazuar në të dhënat që disponohen, është kryer analiza financiare për të parë mundësinë e blerjes së pasurisë apartament me sip. 16.2 m², blerë sipas kontratës datë 10.2.2003 në vlerën 200,000 lekë, ku duket se subjekti nuk ka justifikuar blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme. Si të ardhura janë konsideruar të ardhurat nga punësimi i subjektit, bashkëshortes dhe prindërve të tij, si dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së. Në këtë analizë, depozita dyemërore me vjehrrën e subjektit krijuar në vitin 2001, deri në përfundim të hetimit është konsideruar si pasuri e subjektit (trajtuar hollësisht në vijim). DRSSH Dibër me përgjigjen e saj nuk ka vënë në dispozicion informacion për bashkëshorten e subjektit, pavarësisht se kërkesës i është bashkëlidhur librezja e punës së shtetas M. N.

Përshkrimi	1991 – 10.2.2003
Pasuritë	3,306,069
Apartament lagjja “****”, Peshkopi, nr. ***, z. k. *** (kontratë datë 10.2.2003)	200,000
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>3,106,069</i>
Likuiditete në banka	3,106,069
Cash deklaruar në DPV	-
Gjendja e likuiditeteve	3,106,069
Detyrime	
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	3,306,069
Të ardhurat	3,866,949
Të ardhurat nga paga e subjektit	2,920,636

Të ardhurat nga paga e bashkëshortes	0
Të ardhurat nga pensioni i babait 1996 – 2/2003	385,853
Të ardhurat nga pensioni i nënës 1991 – 2/2003	508,892
Të ardhurat nga interesat e depozitës	51,568
Shpenzimet	3,124,117
Shpenzime jetike	2,176,604
Shpenzime jetike prindërit	947,513
Mundësia për kursime	-2,563,238

18.4. Sa i takon mundësisë financiare për blerjen e automjetit tip “Opel Astra” në vitin 2011, bazuar në deklaratën *Vetting* ku si burim i të ardhurave për blerjen e këtij automjeti janë deklaruar të ardhurat nga shitja e pronës në qytetin e Peshkopisë, pavarësisht mosjustifikimit të blerjes së apartamentit me të ardhura të ligjshme, Komisioni verifikoi deklaratimet e subjektit nga viti 2005 kur është bërë e shitja e apartamentit deri në vitin 2011 kur deklarohet se këto të ardhura janë përdorur për blerjen e automjetit.

Nga leximi i deklaratave periodike vërehet se subjekti i rivlerësimit në DPV-në e viteve 2005 – 2009 nuk ka deklarime për gjendje *cash*, ndërsa në vitet 2010 dhe 2011 ka deklaruar kursime, respektivisht në shumat 700,000 lekë dhe 400,000 lekë, me burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Pra, subjekti nuk ka deklaruar gjendje/shtesë *cash* në deklaratën e pasurisë për vitin 2005 kur është shitur pasuria apartament me sip. 16.2 m² në Peshkopi, si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit nuk rezultojnë të jenë të depozituara në llogaritë e tij bankare në vitin 2005 dhe as më vonë. Në këto kushte, te ardhurat nga shitja e pasurisë apartament në Peshkopi nuk mund të jenë përdorur në vitin 2011 për blerjen e automjetit.

18.5. Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës në lidhje me automjetin objekt verifikimi tip “Opel Astra”, ku duket se: (i) ka mospërputhje të deklaratimit të burimit të krijimit, pasi në DPV-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar si burim “të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes”, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim “të ardhurat nga shitja e apartamentit në Peshkopi”; (ii) subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit në vlerën 5,500 euro në vitin 2011; (iii) ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën - 2,563,238 lekë për mbulimin e shpenzimeve dhe blerjen e apartamentit në Peshkopi. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i është kërkuar subjektit të japë sqarime e dokumente për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

18.6. Në parashtrimet e veta subjekti nuk ka dhënë ndonjë sqarim në lidhje me mospërputhjen në deklaratimin e burimit për blerjen e automjetit tip “Opel Astra” në vitin 2011 me deklaratimin në deklaratën *Vetting*, ku ka ndryshuar burimin. Për sa i përket konstatimit se nuk justifikon me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit në vlerën 5,500 euro, në vitin 2011, me të ardhura nga shitja e apartamentit në Peshkopi (sipas deklaratës *Vetting*), subjekti ka kundërshtuar konstatimin për mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit në Peshkopi, duke parashtruar se balanca negative vjen kryesisht si pasojë e përfshirjes në analizën financiare të depozitës së përbashkët me vjehrrën në vlerën 3,106,069 lekë, e cila duhet hequr pasi, sipas tij, kjo depozitë ka qenë e vjehërrve të tij. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se në analizën financiare duhen shtuar të ardhurat nga pagat e tij deri në vitin 1990 dhe pagat e bashkëshortes, duke rezultuar në këtë mënyrë me një mundësi kursimi prej 1,443,671 lekësh. Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 27.12.2016, të Bashkisë Dibër, sipas të cilit të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes si mësuese për periudhën 1.4.1994 – 2.3.2003 janë në shumën 860,046 lekë. Subjekti ka depozituar gjithashtu edhe deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2024, të lëshuar nga vjehrra

e tij, znj. L. K., në të cilën ajo ka deklaruar se: “*Shuma e depozituar prej 23,000 USD kanë qenë të ardhura të krijuara nga puna e bashkëshortit të saj, z. M. K. (mjek kirurg ORL), nga puna e saj si laborante optike e vetme në qytetin e Peshkopisë dhe rrethit Dibër, si dhe pjesë nga shitjet e apartamentit dhe truallit të z. M. K. në Peshkopi*”.

18.7. Pretendimi i subjektit në lidhje me depozitën e përbashkët me vjehrrën në vlerën 3,106,069 është trajtuar hollësisht në paragrafin 20 të këtij vendimi dhe në përfundim, për efekt të analizës financiare, Komisioni çmoi të konsiderojë si shpenzim apo pasuri të subjektit ½ e shumës së depozituar (në vlerën 1,553,035 lekë), ndërkohë që ½ tjetër e konsideroi si pasuri të vjehërrve të tij. Pas rishikimit të analizës financiare, në konsideratë të sa më sipër, rezultoi se nuk justifikohet blerja e pasurisë në Peshkopi me të ardhura të ligjshme, për shkak të balancës negative prej 438,069 lekësh. Për më tepër, duke qenë se: (i) subjekti nuk ka deklaruar si gjendje/shtesë *cash* në deklaratën e pasurisë për vitin 2005 të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 16.2 m² në Peshkopi, si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit nuk rezultojnë të jenë të depozituara në llogaritë e tij bankare në vitin 2005 dhe as më vonë; (ii) të ardhurat nga shitja e apartamentit në Peshkopi nuk janë deklaruar si burim në DPV-në e vitit 2011, duke u deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*, konstatime për të cilat në parashtrime subjekti nuk ka dhënë ndonjë sqarim, përjashtohet mundësia e ruajtjes së shumës 1,000,000 lekë për t’u përdorur në vitin 2011 për blerjen e automjetit tip “Opel Astra”. Edhe nëse i referohemi burimit të deklaruar në DPV-në e vitit 2011, blerë me të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes nga pagat, nuk justifikohet blerja e automjetit.

18.8. Në lidhje me pretendimin për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga paga e bashkëshortes për periudhën 1992 – 2003, Komisioni vlerëson se ky pretendim është i drejtë dhe i mbështetur në prova dhe mori në konsideratë të ardhurat nga pagat në shumën 859,465 lekë për periudhën 1994 – 10.2.2003, sipas dokumentacionit të depozituar në parashtrime. Në lidhje me pretendimin se në analizën financiare duhen përfshirë edhe të ardhurat e subjektit deri në vitin 1990, Komisioni vlerëson se subjekti jo vetëm nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion për të vërtetuar përfitimin e pagës prej tij, por edhe nëse do të disponohej një informacion i tillë nuk do të kishte efekt në analizën financiare për shkak të nivelit të ulët të pagave para vitit 1990.

18.9. Në përfundim, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në vlerën 5,500 euro, në vitin 2011, pasi nuk u provua që të ardhurat nga shitja e apartamentit në Peshkopi në vitin 2005 të ishin kursyer e më pas përdorur nga subjekti në vitin 2011 për blerjen e automjetit.

19. *Automjet tip “Toyota Yaris”, prodhim i vitit 2000, me targë ***, blerë në vlerën 400,000 lekë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.6.2009. Janë përdorur të ardhurat e fituara nga pagat, ndër vite, të miat dhe të bashkëshortes, si dhe nga shitjet e makinave: (1) tip “Volkswagen” (Golf 2), prodhim i vitit 1987, me targë ***, për shumën 200,000 lekë, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.6.2005; dhe (2) tip “Opel Corsa”, prodhim i vitit 1997, me targë ***, me vlerë 250,000 lekë, të cilën e kam shitur po në shumën 250,000 lekë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2009. Zotërues 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat e fituara ndër vite të subjektit dhe bashkëshortes së tij dhe shitja e dy automjeteve në pronësi të subjektit. ILDKPKI-ja ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.*

19.1. Nga aktet në dosje rezulton se automjeti tip “Toyota Yaris” me targë *** është blerë nga subjekti në datën 24.6.2009 me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 400,000 lekë dhe është regjistruar në emër të tij sipas certifikatës së pronësisë dhe lejes së qarkullimit, sikurse konfirmohet nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2017. Në DPV-në e vitit 2009,

subjekti e ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Toyota Yaris” në vlerën 400,000 lekë, por jo burimin e të ardhurave që janë përdorur për blerjen e tij. Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se automjeti tip “Toyota Yaris” është përdorur nga vjehri i tij, z. M. K., që nga momenti që është blerë e deri në momentin që është shitur për një periudhë pa afat të caktuar kohor dhe deklaroi se të gjitha shpenzimet dhe lëvizjet e kësaj makine janë kryer nga vjehri i tij. Për të vërtetuar këtë deklaratë ai ka vënë në dispozicion një kontratë noteriale huapërdorjeje automjeti të datës 5.7.2011, në të cilën janë të paqarta ekstremitetet e kontratës, por sipas deklaramit të bërë nga vetë subjekti janë nr. *** rep., nr. *** kol. Po kështu ka deklaruar se mjeti tip “Toyota Yaris” është shitur në datën 7.2.2020 me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., të vënë në dispozicion, shitur shtetasit B. Xh. në vlerën 1,000 euro.

19.2. Në lidhje me burimin e krijimit janë analizuar burimet e deklaruara nga subjekti në mënyrë specifike, si vijon:

- Sa i takon të ardhurave nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes, janë konsideruar vetëm të ardhurat për periudhën 1.1.2009 – 24.6.2009, pasi deri në vitin 2009 subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*. Pra, të ardhurat nga pagat para vitit 2009 janë shpenzuar, duke mos u kursyer dhe si të tilla ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e automjetit. Të ardhurat për këtë periudhë ishin në vlerën 376,868 lekë.

- Sa i takon të ardhurave nga shitja e dy mjeteve: (i) tip “Volkswagen Golf 2”, prodhim i vitit 1987, me targë ***, shitur në vlerën 200,000 lekë, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.6.2005; (ii) tip “Opel Corsa”, prodhim i vitit 1997, me targë ***, shitur në vlerën 250,000 lekë, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2009, nga Komisioni janë kryer verifikimet si vijojnë:

19.2.1. Në lidhje me automjetin tip “Volkswagen Golf 2” me targë ***

Në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2003 subjekti ka deklaruar se ka blerë mjetin tip “Volkswagen” 4+1, vit prodhimi 1985, me targë ***, në vlerën 150,000 lekë. Ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2005 subjekti ka deklaruar se e ka shitur mjetin me aktin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.6.2005, në vlerën 200,000 lekë. Duke qenë se subjekti nuk ka vënë në dispozicion kontratat, në pyetësorin nr. 2 i janë kërkuar kontratat përkatëse të blerjes dhe shitjes së mjetit tip “Volkswagen Golf 2”, me targë ***, si dhe burimi i të ardhurave për blerjen e tij në vitin 2003. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave, por ka paraqitur:

a. Fotokopje të kontratës në datën 5.11.2003, nr. *** rep., nr. *** kol., në shumën 250,000 lekë, blerë nga vjehri i tij. Siç vërehet, mjeti është blerë 250,000 lekë dhe jo 150,000 lekë që është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2003.

b. Fotokopje të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.2006, ku z. Saimir Nazifi ia ka shitur këtë mjet blerësit, z. A. B., kundrejt çmimit 200,000 lekë. Siç vërehet, subjekti ka paraqitur një kontratë të vitit 2006 dhe jo kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.6.2005, të deklaruar në DPV-në e vitit 2005 dhe në deklaratën *Vetting*. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuua të japë sqarime dhe të vendosë në dispozicion kontratën e vitit 2005. Në parashtrime subjekti nuk e paraqiti këtë kontratë, duke sqaruar se deri në vitin 2011 nuk i ka ruajtur kopjet e kontratave të blerjeve ose shitjeve të automjeteve. Gjithashtu, sqaron se për shkak se blerësi nuk e kishte regjistruar kontratën e vitit 2005 dhe donte ta regjistronte mjetin në emrin e tij në vitin 2006, palët hartuan një kontratë të re në vitin 2006 me po të njëjtin çmim 200,000 lekë.

Me kërkesë të Komisionit, DPSHTRR-ja² ka vënë në dispozicion kontratën e datës 5.11.2003, me të cilën subjekti e ka blerë këtë automjet, dhe kontratën e datës 11.4.2006, me të cilën subjekti e ka shitur atë.

Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit për të blerë automjetin tip “Volkswagen” në datën 5.11.2003, në vlerën 250,000 lekë, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale, duke analizuar të ardhurat e dokumentuara për periudhën 10.2.2003 – 5.11.2003 të subjektit dhe bashkëshortes së tij, si dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së, e cila paraqitet në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë³.

Përshkrimi	10.2.2003 – 5.11.2003
Pasuritë	250,000
Automjet tip “Volkswagen”, vit prodhimi 1985, me targë *** (***) datë 5.11.2003	250,000
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	-
Likuiditete në banka	3,106,069
<i>Cash</i> deklaruar në DPV	-
Gjendja e likuiditeteve	3,106,069
Detyrime	-
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	250,000
Të ardhurat	517,916
Të ardhurat nga paga e subjektit	517,916
Të ardhurat nga paga e bashkëshortes	
Shpenzimet	281,892
Shpenzime jetike	281,892
Mundësia për kursime	-13,976

Nga sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një balancë negative në një vlerë të pakonsiderueshme, duke mos cenuar në këtë mënyrë ligjshmërinë e burimit të krijimit për blerjen e automjetit tip “Volkswagen” më 5.11.2003.

Për sa i takon përdorimit të të ardhurve nga shitja e automjetit tip “Golf 2” në shumën 200,000 lekë në vitin 2006, deklaruar si burimi krijimi për blerjen e automjetit tip “Toyota Yaris”, objekt verifikimi në datën 24.6.2009, është konstatuar se ato nuk janë deklaruar si kursime në vitin 2006 dhe as nuk kanë qenë të depozituara në bankë dhe prandaj nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Toyota Yaris” më 24.6.2009.

19.2.2. Në lidhje me automjetin tip “Opel Corsa” me targë ***

Në DPV-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar se ka blerë automjetin tip “Opel Corsa” me targë ***, në datën 31.12.2005, por nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e këtij mjeti. Në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se mjeti tip “Opel Corsa” me targë ***, prodhim i vitit 1998, është blerë në Itali, si dhe është zhdoganuar nga ai vetë në vitin 2005, në vlerën totale 260,000 lekë. Duke iu referuar certifikatës së pronësisë së mjetit me datë 9.4.2006, rezulton se pronësia mbi këtë mjet është fituar nga subjekti nëpërmjet faturës nr. ***, datë 19.10.2005.

DPSHTRR-ja ka përcjellë dosjen e automjetit tip “Opel Corsa” me targë ***, i vitit 1998, ku rezulton se ky mjet është blerë në datën 19.10.2005 nga z. Saimir Nazifi për çmimin 540 euro.

² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2024, të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit.

³ Analiza është kryer e fragmentuar, pasi në datën 10.2.2003 është blerë apartamenti me sip. 16.2 m².

Dokumenti doganor i datës 31.12.2005 pasqyron pagesën e doganës në Durrës në shumën 174,276 lekë. Në përfundim, subjekti ka paguar për automjetin vlerën 540 euro x 122.79 + 174,624 lekë = 240,930 lekë vlerë totale. Me kontratën e datës 12.2.2009 z. Saimir Nazifi ia shet këtë automjet blerësit A. C. me çmimin 250,000 lekë.

Për sa rezulton më sipër, si dhe duke marrë parasysh pagesat e kryera për pajisjen me dokumentacion në momentin e regjistrimit të automjetit, Komisioni ka marrë në konsideratë si vlerë të blerjes së automjetit tip “Opel Corsa” shumën 250,000 lekë, ashtu si është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2005. Shitja e këtij mjeti vërtetohet me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2009, kundrejt çmimit 250,000 lekë.

Sa i takon mundësisë financiare për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa” në vitin 2005, është kryer analiza financiare, referuar deklarimeve në pyetësorë, ku si burim subjekti deklaroi se kanë shërbyer: (1) të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen” me targë ***, në vlerën 200,000 lekë; dhe (2) gjendje në shtëpi, analizuar si vijon:

a. Në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen” me targë ***, në DPV-në e vitit 2005 subjekti deklaroi: “Kam shitur makinën Volkswagen të deklaruar vitin e kaluar me targë *** me aktin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.6.2005. Vlera 200,000 lekë”. Me kërkesë të Komisionit për të vënë në dispozicion këtë kontratë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka depozituar kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.2006, me të cilën i është shitur blerësit A. B. mjeti tip “Volkswagen Golf” me targë ***, për çmimin 200,000 lekë. Edhe DPSHTRR-ja konfirmon shitjen e automjetit tip “Volkswagen Golf” nga subjekti nëpërmjet kontratës së shitjes datë 11.4.2006. Në kushtet kur mungonte një akt noterial i datës 20.6.2005, në përfundim të hetimit u konsiderua se të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf 2” me targë ***, për çmimin 200,000 lekë, me kontratën e datës 11.4.2006, nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa” në datën 19.10.2005, pasi ato janë realizuar në datën 11.4.2006, shumë kohë pas blerjes së automjetit tip “Opel Corsa”.

b. Në lidhje me burimin e dytë të deklaruar “gjendje në shtëpi”, është verifikuar DPV-ja e vitit 2004, ku subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*. Për këtë arsye, “gjendje në shtëpi” e përdorur për blerjen e automjetit është krijuar me të ardhurat e vitit 2005 deri në momentin e kryerjes së pagesave.

Për efekt të verifikimit të mundësisë financiare të subjektit për të blerë automjetin tip “Opel Corsa” në datën 19.10.2005 me çmimin 540 euro ose 66,307 lekë (sipas kursit të këmbimit) dhe paguar në datën 31.12.2005 detyrimet doganore dhe shpenzimet e tjera në total prej 183,693 lekësh (250,000 - 66,307 lekë), janë analizuar të ardhurat e dokumentuara për periudhën 1.1.2005 – 31.12.2005 të subjektit dhe bashkëshortes së tij, si dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së, siç paraqitet në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

Përshkrimi	2005
Pasuritë	252,351
Automjet tip “Opel Corsa” me targë ***, datë 31.12.2005	250,000
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	2,351
Likuiditete në banka	2,351
<i>Cash</i> deklaruar në DPV	-
Gjendja e likuiditeteve	2,351
Detyrime	-
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	252,351
Të ardhurat	1,822,707

Të ardhurat nga paga e subjektit	712,061
Të ardhurat nga paga e bashkëshortes	110,646
Të ardhura nga vajza	
Të ardhura nga shitja e apartamentit në lagjen “****”, Peshkopi (kontratë datë 26.8.2005)	1,000,000
Shpenzimet	565,057
Shpenzime jetike	438,228
Shpenzime TIMS	126,829
Mundësia për kursime	1,005,299

Siç vërehet, subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa”. Në këto kushte, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Opel Corsa” në shumën 250,000 lekë, në datën 12.2.2009, janë konsideruar si burim për blerjen e automjetit tip “Toyota Yaris” në datën 24.6.2009.

19.3. Komisioni, duke u bazuar në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, analizoi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit tip “Toyota Yaris” në datën 24.6.2009, në vlerën 400,000 lekë, paraqitur në tabelën si më poshtë:

Përshkrimi	1.1.2009 – 24.6.2009
Pasuritë	421,859
Automjet tip “Toyota Yaris” me targë ***, datë 24.6.2009	400,000
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	21,859
Likuiditete në banka	28,190
<i>Cash deklaruar në DPV</i>	-
Gjendja e likuiditeteve	28,190
Detyrime	(126,923)
<i>Pagesë kësti (principal + interes)</i>	<i>(126,923)</i>
Pasuri net (pasuri - detyrime)	548,782
Të ardhurat	626,868
Të ardhurat nga paga e subjektit	303,524
Të ardhurat nga paga e bashkëshortes	73,344
Të ardhura nga shitja e mjetit me targë ***, datë 12.2.2009	250,000
Shpenzimet	311,065
Shpenzime jetike	273,240
Shpenzime TIMS	37,249
Shpenzime komisione bankare/penalitete	575
Mundësia për kursime	-232,979

19.4. Në përfundim të hetimit, në lidhje me automjetin objekt vlerësimi tip “Toyota Yaris”, blerë në datën 24.6.2009, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i është kërkuar të vërtetojë të kundërtën e konstatimeve, ku duket se: (i) të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf 2”, shitur në vitin 2006, nuk mund të kenë shërbyer si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa”⁴ blerë në vitin 2005 sepse janë krijuar pas blerjes së tij; (ii) subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 232,979 lekë për blerjen e automjetit tip “Toyota Yaris” në datën 24.6.2009.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

⁴ Ka një lapsus në rezultatet e hetimit, ku gabimisht është shënuar mjeti tip “Toyota Yaris”.

19.5. Në prapësimet e tij subjekti pretendon se automjeti tip “Volkswagen Golf 2” është shitur prej tij me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.6.2005, kohë në të cilën janë marrë edhe paratë, por sipas tij kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.2006, është ribërë për shkak se blerësi kishte humbur kontratën e shitblerjes të vitit 2005 dhe nuk po e regjistronte dot automjetin. Ky pretendim është jo vetëm deklarativ, por edhe i paarsyeshëm, pasi nëse transaksioni do të ishte kryer në vitin 2005 sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.6.2005, të pretenduar nga subjekti, palët e kësaj kontrate kishin të gjithë mundësinë për ta rimarrë një kopje të saj nga zyra noteriale ku ishte përpiluar kontrata, pa qenë nevoja për të ribërë një kontratë tjetër në vitin 2006. Në këto kushte, subjekti nuk ka provuar që shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf 2”, vërtetuar me kontratë noteriale në vitin 2006, ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Opel Corsa” në vitin 2005.

Edhe nëse Komisioni do të merrte në konsideratë pretendimin e subjektit se automjeti tip “Volkswagen Golf 2” është shitur në vitin 2005, përsëri të ardhurat nga shitja e tij nuk do të kishin shërbyer si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit tip “Toyota Yaris” në vitin 2009, pasi nga deklaratat periodike nuk rezultoi që të ardhurat nga shitja të jenë deklaruar si kursim *cash* apo si likuiditet bankar në vitin 2005, si dhe as në vitin 2006. Për më tepër, subjekti i ka deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Golf” (sipas tij në vitin 2005) si burim për blerjen e dy automjeteve: Toyota Yaris blerë në vitin 2009 dhe Opel Corsa në vitin 2005.

Në përfundim të procesit rezultoi se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme në shumën 232,979 lekë për blerjen e automjetit tip “Toyota Yaris”.

20. *Llogari depozite e çelur në ish-Bankën Amerikane (blerë nga Intesa Sanpaolo Bank) datë 26.12.2002, së bashku me shtetasen L. K. (vjehera ime), në shumën 23,014.74 USD. Kjo llogari është mbyllur në datën 28.11.2004. Theksoj se kjo shumë ka qenë e vjehrrës time, sepse unë jam futur në këtë depozitë vetëm për të tërhequr në rast nevojë, pasi ajo banonte akoma në qytetin e Peshkopisë në atë kohë. Zotërues 0% subjekti.* ILDKPKI-ja ka konstatuar se subjekti nuk e ka deklaruar këtë depozitë në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, ndërsa në deklaratën e rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin financiar të vjehrrës që ka shërbyer për krijimin e saj. Gjithashtu nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me të.

20.1. Në lidhje me këtë depozitë është konstatuar se:

- Subjekti nuk e ka deklaruar në DPDFD-në e vitit 2003, ndërsa në deklaratën *Vetting* nuk ka deklaruar burimin financiar për krijimin e kësaj depozite bankare, gjithashtu nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me të.

- Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se veprimet e vetme që ai ka kryer për këtë llogari janë: (i) hedhja e 23,000 USD të shtetasve M. e L. K. në datën 26.12.2002; (ii) tërheqja e 23,014 USD më 26.11.2004 për pagesën e këstit të shtëpisë që ai do të blinte (nuk është e qartë se kush është personi që do të blinte dhe cilën pasuri do të blinte). Subjekti ka paraqitur vërtetimin e Intesa Sanpaolo Bank, në të cilin nuk ka të dhëna se nga kush është depozituar dhe tërhequr kjo shumë.

20.2. Duke qenë se subjekti ka qenë bashkëmbajtës i depozitës objekt vlerësimi së bashku me vjehrrën si dhe, referuar faktit që subjekti dhe bashkëshortja kanë përdorur një apartament në pronësi të vjehrrit pa ndërprerje dhe pa kundërshtim që nga viti 2004 deri në vitin 2021, trajtuar në vijim, është vlerësuar se shtetasit M. dhe L. K. janë persona të tjerë të lidhur, sipas parashikimit të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

20.3. Me qëllim evidentimin e lidhjeve të subjektit me këtë depozitë, nga Komisioni u kryen verifikimet e të dhënave bankare, nga ku rezultoi se:

- Sipas vërtetimit të lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank në datën 23.1.2017, z. Saimir Nazifi ka pasur një llogari të përbashkët me znj. L. K. pranë Bankës Amerikane, tek e cila në datën 26.12.2002 kanë hapur një depozitë me afat në shumën 23,014.74 USD, depozitë e cila është mbyllur në datën 26.11.2004, fakt ky që konfirmohet edhe me kthim përgjigjen e datës 23.3.2016, e cila informon se subjekti ka pasur depozitë në USD për periudhën 31.12.2003 – 2.11.2004 pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., me nr. *** (*base number*), të përbashkët me znj. L. K. .

- Intesa Sanpaolo Bank informon se subjekti ka pasur llogari të përbashkët me znj. L. M. K. me nr. *** (*base number*), duke vendosur bashkëlidhur dokumentacionin, nga ku ka rezultuar se në datën 16.7.2001 subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën 15,000 USD, duke çelur një depozitë. Në datën 26.9.2002 u shtua kjo depozitë me shumën 7,600 USD, për të cilën banka nuk ka depozituar një dokumentacion nga ku mund të identifikohet se cili është depozituesi.

- Në vijim të kronologjisë⁵ së veprimeve, në datën 26.12.2002 është maturuar depozita në shumën 23,014.74 USD dhe është riçelur një depozitë e re për këtë vlerë në llogarinë dyemërore. Pas maturimit të depozitës në vlerën 23,351.62 USD, në datën 26.11.2004 subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash* shumën 23,307.54 USD, duke e mbyllur këtë llogari dyemërore.

Nga të dhënat bankare si më sipër, rezulton se ndryshe nga sa ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe përgjigje të pyetësorit standard në lidhje me çeljen e një depozite bankare në vlerën 23,000 USD në datën 26.12.2002, përpara këtij veprimi, në datën 16.7.2001 subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën 15,000 USD në llogarinë e përbashkët me vjehrrën dhe me këtë shumë ka hapur një depozitë.

20.4. Është pyetur subjekti duke iu kërkuar informacion në lidhje me mosdeklarimin e depozitës dyemërore në DPFĐ-në e viteve 2003 dhe 2004; për cilin person e ka pasur fjalën në përgjigjen e dhënë në pyetësorin standard, ku ka deklaruar: *“Tërheqja e 23,014 USD më 26.11.2004 për pagesën e këstit të shtëpisë që ai do të blinte”*; përse kjo llogari është çelur në emrin e tij dhe të vjehrrës së tij dhe jo në emër të bashkëshortes dhe nënës së saj; të japë sqarime mbi burimin dhe të dokumentojë të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e shumës 23,014 USD.

20.5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se *kjo depozitë bankare është hapur në Tiranë për arsye të mosmbajtjes së parave në shtëpi, pasi vjehrrë dhe vjehrra e tij jetonin të vetëm në Peshkopi në atë kohë dhe nuk donin të mbanin para gjendje në shtëpi. Ai ka deklaruar se kjo llogari është hapur në emrin e subjektit dhe jo të bashkëshortes së tij, për arsyen se bashkëshortja e tij nuk kishte ardhur ende përfundimisht në Tiranë, pasi ajo dhe vajzat jetonin me prindërit në Peshkopi. Të gjitha veprimet e mundshme bankare që mund të duheshin si derdhje, tërheqje etj. do të kryheshin nga subjekti, pa qenë të detyruar që bashkëshortja të udhëtonte nga Peshkopia në Tiranë.*

Subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e kësaj depozite në DPV-në e viteve 2003 – 2004. Ai ka pranuar se veprimet e kryera për këtë llogari janë depozitimi i shumës 23,000

⁵ Me njoftimin e kreditimit datë 16.1.2002 banka njofton se shuma e kredituar në llogari për shkak të maturimit të depozitës është në vlerën 15,204.16 USD. Me njoftimin e debitimit të llogarisë datë 11.3.2002 është rinovuar depozita. Në datën 26.9.2002, depozita është maturuar në shumën 15,315.16 USD dhe në po të njëjtën datë, sipas njoftimit të debitimit të llogarisë, banka njofton kalimin e shumës 22,947.8 USD në depozitë me afat. Duket se rritja e vlerës së depozitës me rreth 7,600 USD është shumë më e madhe se ajo që mund të vijë nga shtimi i interesave kjo shtesë duket se është krijuar nga ndonjë depozitim *cash*, për të cilin banka nuk ka disponuar me dokumentacion nga ku të mund të identifikohet personi që ka kryer veprimin e depozitimit.

USD me të ardhura të shtetasve M. dhe L. K. në datën 26.12.2002 dhe tërheqja e 23,014 USD në datën 26.11.2004 për pagesën e një kësti të shtëpisë që vjehri M. K. do të blinte dhe për shpenzime të tij familjare, meqenëse u transferua përfundimisht në Tiranë. Sipas subjektit, llogaria u boshatis në datën 26.11.2004 dhe me shumën e tërhequr në datën 30.11.2004 prej 23,014 USD, u pagua kësti për shtëpinë në Durrës nga vjehri (pas 4 ditësh).

20.6. Komisioni kreu disa verifikime në lidhje me pasurinë e blerë nga vjehri M. K. në Durrës, sipas të cilave u vërtetua se:

- Notere V. P. ka vënë në dispozicion kontratën e shitjes midis shoqërisë “****”sh.p.k. dhe z. M. K., për blerjen e apartamentit me sip. 46.70 m², nr. pasurie ***, Durrës, rruga “****”, kundrejt çmimit 22,500 euro. Në kontratë shkruhet se pala shitëse “****”sh.p.k. dhe pala blerëse kanë lidhur marrëveshje porosie në datën 15.9.2001, ku palët kanë përcaktuar çmimin e shitjes dhe mënyrën e pagesës. Më pas në kontratë është përmendur një aktmarrëveshje mes palëve në datën 30.11.2004 me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe bashkëlidhur ndodhet akti *Aktmarrëveshje porosie për punimet që kryen me prenotim*, me datë 30.11.2004, midis palëve shoqëria “****” sh.p.k. dhe z. M. K., në të cilën nuk është përcaktuar çmimi i shitjes, ndërkohë që është parashikuar që vlera prej 15,000 euro është paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës. Bashkëlidhur kësaj aktmarrëveshjeje porosie janë 3 mandate të paguara nga z. M. K., përkatësisht mandati nr. ***, datë 30.11.2004 (4 dite pasi subjekti ka tërhequr shumën 23,000 USD) në shumën 15,000 euro, mandati nr. ***, datë 17.1.2005 për shumën 5,000 euro, mandati nr. ***, datë 26.5.2005 për vlerën 2,500 euro, në të cilat nuk është shënuar emri i shoqërisë përfituese të shumave përkatëse dhe as adresa e pasurisë.

20.7. Me qëllim heqjen e dyshimeve për dy pasuri të blera nga vjehri i subjektit, u kryen verifikimet si vijojnë:

- Iu dërgua shkresë shoqërisë “****” sh.p.k. lidhur me këtë pasuri, e cila u kthye nga shërbimi postar me shënimin mbi zarf “*Larguar*”.

- Iu dërgua shkresë ASHK-së Durrës për të dërguar dosjen e plotë të pasurisë dhe në shkresën kthim përgjigjeje ASHK-ja informon se nga verifikimi në sistemin multifunksional pasuria nr. *** është në bashkëpronësi midis shtetaseve L. K. (4/6 pjesë), M. N. (1/6 pjesë) dhe N. K. (1/6 pjesë).

- U kërkuan të dhëna për një konflikt të mundshëm interesi dhe u vërtetua se subjekti nuk ka pasur në trajtim çështje të shoqërive “****”sh.p.k. apo “****.” sh.p.k. dhe ortakët e tyre.

- I është ridërguar shkresë ASHK-së Durrës, e cila vuri në dispozicion dosjen e plotë të pasurisë nr. ***.

- Iu rikërkua informacion noteres V. P. në datën 29.4.2024, e cila vuri në dispozicion të dhëna në lidhje me pasurinë nr. ***, të blerë nga shtetasi M. K. në Durrës.

- Iu kërkua informacion FSHU-së, e cila konfirmoi se në emër të shtetasit M. K. figurojnë dy kontrata energjie në Durrës.

20.8. Në një analizë të akteve të administruara rezultoi se: (i) vjehri i subjektit ka blerë pasurinë nr. *** në Lagjen ***, ***, Durrës, nga shoqëria “****”sh.p.k. me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2017; (ii) ka të dhëna që tregojnë se shtetasi M. K. mund të ketë blerë një pasuri tjetër në Durrës përveç asaj me nr. ***, në Lagjen ***, ***. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti iu kërkua të japë sqarime e dokumente për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi ose dokumente që vërtetojnë pronësinë dhe mënyrën e fitimit të kësaj pasurie nga vjehri/vjehrra. Në prapësimet e tij subjekti ka pretenduar që vjehri M. K. nuk ka blerë një pasuri tjetër në Durrës dhe se shuma prej 23,000 USD e tërhequr në datën 26.11.2004 është përdorur për

të blerë të vetmin apartament, që është pasuria nr. *** në Lagjen ***, ***, Durrës, duke paraqitur disa argumente e dokumente shkresore për të vërtetuar këtë fakt, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- ASHK Durrës ka konfirmuar se z. M. K. ka vetëm një pasuri të regjistruar pranë këtij institucioni.
- Të dhënat që konstaton raporti nuk qëndrojnë sepse z. M. S. K. ka vetëm një kontratë me OSHE-në për energjinë elektrike në Durrës, ndërsa kontrata e dytë e një apartamenti në Durrës është e një zotërie tjetër me emrin M. Z. K., i datëlindjes 1955, provuar me kontratën e FSHU-së Durrës në emër të z. M. Z. K., të cilën subjekti e ka vënë në dispozicion.
- Vjehri M. S. K. ka vetëm një kontratë me energjinë dhe ujësjellësin në Durrës, të cilat subjekti i ka vendosur bashkëngjitur.
- Dokumentacioni i sjellë nga ASHK-ja në Komision për pasurinë nr. *** në Lagjen ***, ***, Durrës është i plotë dhe tregon gjithë ecurinë e blerjes së apartamentit me sip. 46.7 m².
- Prenotimi i këtij apartamenti është kryer më 30.11.2004 (dokumentacion i cili është dorëzuar në përgjigje të pyetësorit nr. 2).
- Pagesa kryesore është kryer në datën 30.11.2004, vetëm 4 ditë pas tërheqjes së parave nga llogaria bankare e dyfishtë, për të cilën subjekti ka theksuar se si depozitimi dhe tërheqja nga banka është kryer nga të dy mbartësit e llogarisë dhe i është dorëzuar z. M. K..
- Të gjitha mandatet e pagesave janë bashkëlidhur në dosjen e sjellë nga ASHK-ja në Komision, ku ndodhet edhe mandati 15,000 euro për pagesën e parë të prenotimit të banesës me sip. 46.7 m² dhe për këtë arsye subjekti pretendon se arsyetimi i Komisionit që me këtë mandat mund të jetë paguar një pasuri tjetër nuk qëndron, pasi nuk mundet i njëjti mandat të përdoret në dy shoqëri të ndryshme.
- Pagesa e 15,000 eurove është kësti i parë dhe nuk u pagua e plotë e gjithë shuma sepse ndërtesa ishte akoma në ndërtim. Ndërsa kësti i dytë është paguar në vitin 2005 dhe kësti i tretë është paguar në vitin 2017, në momentin që shoqëria bëri të mundur regjistrimin e pronës dhe kalimin e pronësisë.
- Kontrata e shitjes është kryer në vitin 2017, ndërsa banorët kanë filluar të jetojnë që nga vitet 2005 dhe 2006. Vonesa nga ndërtimi deri në regjistrimin e pasurisë është për arsye se ndërtuesi kishte kryer kat shtesë pa leje.

20.9. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti e ka lidhur tërheqjen e shumës 23,000 USD në datën 26.11.2004 nga llogaria dyemërore me vjehrën, me pagesën në *cash* të kështit prej 15,000 euro 4 ditë më vonë, në datën 30.11.2004, për blerjen e pasurisë në Durrës nga vjehri. Por, në përfundim të hetimit administrativ ky fakt mbetet në nivel deklarativ e i pavërtetuar, pasi nuk u administrua ndonjë akt që të vërtetojë dorëzimin e shumës nga subjekti te vjehri i tij apo ndonjë pagesë në rrugë bankare të çmimit të blerjes së pasurisë nga vjehri në Durrës. Nga ana tjetër, mbetet e paqartë përse e gjithë kjo shumë nuk është përdorur për blerjen e apartamentit në Durrës nga vjehri sipas deklarimeve të subjektit pasi pas pagimit të kështit 15,000 euro kanë tepruar edhe rreth 2,160 euro. Ndërkohë, është vërtetuar që subjekti ka filluar të banojë që në vitin 2004 në një apartament tjetër të blerë nga vjehri i tij në Tiranë në vitin 2006, për të cilin nuk ka të dhëna si është bërë pagesa e çmimit të blerjes. Në këto kushte, për Komisionin nuk përjashtohet mundësia e përdorimit të shumës 23,000 USD të tërhequr prej subjektit nga llogaria dyemërore me vjehrën në datën 26.11.2004, për të paguar pikërisht blerjen e këtij apartamenti në Tiranë (trajtuar në vijim, për të cilin janë ngritur dyshime për një pasuri të fshehur të subjektit).

20.10. Në analizë të të gjitha provave të administruara, në përfundim të procesit Komisioni nuk mund të konkludojë për blerjen e një apartamenti tjetër nga ana e vjehrrit të subjektit në Durrës, ashtu sikurse nuk mund të arrihet në konkluzionin që shuma 23,000 USD, e tërhequr në datën 26.11.2004 nga subjekti, është përdorur për pagesën në *cash* të këstit prej 15,000 euro në datën 30.11.2004 nga vjehri për blerjen e pasurisë në Durrës, për sa kohë në mandatpagesat që i janë bashkëlidhur kontratës së shitjes së kësaj pasurie të paraqitur pranë ZVRPP-së, nuk përcaktohet emri i shoqërisë ndërtuese dhe as adresa ku ndodhet apartamenti, si dhe për sa kohë nuk ka një provë që të vërtetojë që shuma e tërhequr nga subjekti i është dhënë vjehrrit M. K. Për më tepër, mbetet e paqartë përse shuma 23,000 USD nuk u tërhoq në datën 26.11.2004 nga vjehrra e subjektit si bashkëmbajtëse e llogarisë dhe bashkëpronare e apartamentit që vjehri bleu në Durrës, në kushtet kur sipas vetë deklarimeve të subjektit në parashtrime, depozitimet dhe tërheqjet janë kryer nga të dy. Edhe në seancë subjekti ka deklaruar se ka qenë vetëm shoqëruesi i vjehrrës ditën e tërheqjes së shumës 23,000 USD.

20.11. Komisioni ka kryer analizën financiare për të parë mundësinë e prindërve të bashkëshortes për të krijuar depozitën në USD në ish-Bankën Amerikane, konkretisht depozitim e shumës 15,000 USD në datën 16.7.2001 dhe shumës 7,600 USD në datën 26.9.2002. Në analizën financiare të paraqitur në tabelën si më poshtë, janë konsideruar të ardhurat nga punësimi i vjehrrit të subjektit, si dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive, duke përfshirë edhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së.

Përshkrimi	1994 – 16.7.2001
Pasuritë	6,164,992
Ap. me sip. 57.1 m ² , nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, rruga “****”, 30.5.2001	1,900,000
Ap. nr. ***, p. ***, shk. ***, k. *** (nr. pasurie ***), lagjja “****”, Dibër, 26.8.1993	0
Ap. P***, k. ***, lagjja “****”, 11.8.1995	750,000
Dyqan, kati ***, lagjja “****”, 11.11.1995	200,000
Shtëpi private, lagjja “****”, Peshkopi (trashëgimi)	
Ap. me sip. 54 m ² , nd. ***, ap. ***, nr. pasurie ***, z. k. ***, rruga “****”, blerë më 26.5.1999/jeton L. K.	700,000
Automjet Volkswagen Golf, 31.8.1999, me targë ***, 31.8.1999	559,392
Truall me nr. pasurie ***, z. k. ***, 504.44 m ² në bashkëpronësi me trashëgimi	
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	
Likuiditete në banka (depozituar 15,000 USD më 16.7.2001)	2,055,600
<i>Cash</i> deklaruar në DPV	0
Gjendja e likuiditeteve	2,055,600
Detyrime	0
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	4,109,392
Të ardhurat	1,854,257
Të ardhura M. K. 1994 – 7.2001	1,204,257
Të ardhurat nga aktiviteti L. K. 1994 – 2001	0
Të ardhurat nga shitja e ap. nr. ***, p. ***, shk. ***, k. ***, Dibër, 21.8.1995	650,000
Shpenzimet	899,647
Shpenzime jetike	899,647
Mundësia për kursime	-5,210,382

Siç duket, prindërit e bashkëshortes nuk kanë pasur mundësi për të kursyer të ardhura të ligjshme për depozitim e shumës 15,000 USD në datën 16.7.2001, për shkak të balancës negative prej 5,210,382 lekësh. Analiza financiare është kryer duke marrë në konsideratë të gjitha të dhënat që

disponohen për pasuri të prindërve të bashkëshortes deri në datën 16.7.2001, duke qenë se këta janë persona të tjerë të lidhur dhe janë ngritur dyshime për pasuri të fshehur të tyre në emër të bashkëshortes së subjektit.

20.12. Komisioni analizoi edhe mundësinë e prindërve të bashkëshortes për të shtuar depozitën me 7,600 USD në datën 26.9.2002, nga ku, pasi u morën në konsideratë të ardhurat nga punësimi i vjehrrit të subjektit për këtë periudhë, si dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së, pa përfshirë në analizë të ardhurën nga shitja e shtëpisë private në Peshkopi, e deklaruar në vlerën 950,000 lekë (e paprovuar me dokumentacion), rezultoi se ata nuk kanë pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të shtuar depozitën me 7,600 USD.

Përshkrimi	16.7.2001 – 26.9.2002
Pasuritë	1,072,635
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i> (depozituar 7,600 USD më 26.9.2002)	1,072,635
Likuiditete në banka	3,128,235
<i>Cash</i> deklaruar në DPV	0
Gjendja e likuiditeteve	3,128,235
Detyrime	0
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	1,072,635
Të ardhurat	380,423
Të ardhura M. K. 1994 – 2003 – 2016	337,889
Të ardhurat nga interesat e depozitës	42,534
Shpenzimet	230,841
Shpenzime jetike	230,841
Mundësia për kursime	-923,053

20.13. Po kështu, është verifikuar edhe mundësia e subjektit për dy depozitimet si më sipër, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	1991 – 15.7.2001	15.7.2001 – 26.9.2002
Pasuritë	2,055,600	1,072,635
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	2,055,600	1,072,635
Likuiditete në banka	2,055,600	3,128,235
<i>Cash</i> deklaruar në DPV	-	-
Gjendja e likuiditeteve	2,055,600	3,128,235
Detyrime		
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	2,055,600	1,072,635
Të ardhurat	2,703,146	769,613
Të ardhurat nga paga e subjektit	2,045,517	554,455
Të ardhurat nga paga e bashkëshortes		
Të ardhurat nga pensioni i babait 1996 – 2/2003	267,295	86,312
Të ardhurat nga pensioni i nënës 1991 – 2/2003	390,334	86,312
Të ardhurat nga interesat e depozitës		42,534
Shpenzimet	2,196,789	692,523
Shpenzime jetike	1,558,385	461,682
Shpenzime jetike prindërit	638,404	230,841
Mundësia për kursime	-1,549,243	-995,545

Siç vërehet, edhe subjekti nuk ka pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojë depozitën dhe shtesën e saj.

20.14. Në përfundim të hetimit administrativ janë ngritur dyshime për pronësi të fshehur të subjektit mbi depozitën bankare objekt verifikimi, referuar fakteve si vijojnë:

- Subjekti është përpjekur të fshehtë depozitën dyemërore me vjehrrën, të çelur prej tij në vitin 2001, kur ka qenë me detyrën e gjyqtarit, duke mos e deklaruar atë në DPFĐ-në e vitit 2003 dhe DPV-në e vitit 2004, ndërkohë që të gjitha veprimet (depozitimet/tërheqjet) në llogarinë bankare në Intesa Sanpaolo Bank janë kryer prej tij. Ndërsa në deklaratën *Vetting* (kur depozita nuk ka qenë më ekzistente) subjekti e ka deklaruar atë, por pa deklaruar burimin e krijimit të saj.
- Nuk është justifikuar me të ardhura të ligjshme të vjehërrve (dhe as të subjektit) burimi i të ardhurave për depozitimet e shumave 15,000 USD dhe 7,600 USD, përkatësisht në vitet 2001 dhe 2002.

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime e dokumente për të vërtetuar që nuk është në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

20.15. Në prapësimet e veta, në lidhje me llogarinë bankare dyemërore me vjehrrën, subjekti ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit, duke parashtruar se:

- Nuk ka pasur detyrim të plotësojë DPFĐ-në e vitit 2003.
- Paratë nuk kanë qenë të tijat, pavarësisht depozitës së përbashkët.
- Si depozitimi dhe tërheqja janë kryer nga të dy personat (ai dhe vjehërra).
- Siç ka theksuar, emri i tij u vendos për arsye administrative (në qoftë se do të kishte nevojë për lëvizje dhe vjehërrin e vjehërra nuk do kishin mundësi të vinin nga Peshkopia).
- Në procesverbalin e mbajtur me inspektorët e ILDKPKI-së më 20.6.2016, ai e ka deklaruar dhe sqaruar se në fakt e kishte harruar këtë depozitë bankare.
- Vjehërrin dhe vjehërra në periudhën 2001 – 2003 filluan të shesin të gjitha pasuritë që kishin në Peshkopi (kanë shitur shtëpinë e vjetër private, apartamentet që kishin dhe të gjithë truallin), si dhe kanë pasur të ardhura historikisht ndër vite, të cilat subjekti i ka shpjeguar edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2.
- Vjehërrit nuk mund t'i bëhet *Vetting* i shkëputur në vite.
- Është plotësisht e konfirmuar që menjëherë pas tërheqjes së depozitës së përbashkët, pjesa më e madhe e këtyre parave është përdorur nga vjehërrin për të prenotuar apartamentin me sip. 46.7 m² në ***, Durrës, pasi ASHK Durrës ka dërguar në Komision mandatin e parë të pagesës për prenotim të apartamentit me sip. 46.7 m² në vlerën 15,000 euro, të kryer vetëm 4 ditë pas tërheqjes. ASHK Durrës ka informuar se në emër të z. M. K. figuron e regjistruar vetëm një apartament në adresën Lagjja ***, ***, Durrës. Z. M. K. ka vetëm një kontratë për energjinë dhe ujin në Durrës (kontrata tjetër me emrin M. K., siç u sqarua me sipër, është e z. M. Z. K., i datëlindjes 1955).
- Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale datë 4.6.2024, ku vjehërra L. K. ka deklaruar se depozita e përbashkët ka qenë në pronësi të saj dhe të bashkëshortit.

Në seancë dëgjimore, i pyetur nga Komisioni në lidhje me depozitën dyemërore, subjekti ka shpjeguar se ai ka qenë gjithmonë shoqëruar i vjehërrës për shkak të moshës, si dhe për siguri të vlerave monetare.

Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme të vjehërrit dhe vjehërrës për hapjen e depozitës dhe shtesën e saj, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si gjatë hetimit. Në parashtrime subjekti ka

depozituar një deklaratë noteriale të z. A. K. (nipi i vjehrrit të subjektit) të datës 6.6.2024, i cili deklaroi se nga shitja e shtëpisë private në Peshkopi që M. K. ka pasur në bashkëpronësi me babain e tij ka përfituar secili nga 950,000 lekë, si dhe nga shitja e trojeve kanë përfituar nga mbi 1,000,000 lekë, por nuk disponon dokumentacion pasi veprimet janë kryer prej babait dhe xhaxhait të tij. Komisioni vlerëson se edhe nëse do të merrej në konsideratë deklarimi i shtetasit A. K. në lidhje me të ardhurat nga shitja e pronave (do të përfshihej vetëm e ardhura nga shitja e shtëpisë private në vitin 2002), përsëri vjehri dhe vjehrra e subjektit do të rezultonin me mungesë burimesh të ligjshme për hapjen e depozitës në vitin 2001 dhe shtesën e saj në vitin 2002. Për të ardhurat nga shitja e trojeve në shumën mbi 1,000,000 lekë, vlen të përmendet se pronarëve u është njohur prona me vendimin e gjykatës datë 17.2.2009 dhe si rrjedhim të ardhurat e përfituara janë krijuar pas kësaj periudhe dhe nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e depozitave.

20.16. Në analizë të parashtrimeve dhe të të gjitha provave të administruara, rezultoi se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve të dërguara nga Komisioni në lidhje me depozitën dyemërore, arsyetuar si vijon:

- Për sa i përket pretendimit se nuk ka pasur detyrim për të plotësuar deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, i mbështetur edhe me deklaratimet në seancë dëgjimore ku pas pyetjes në lidhje me mosdeklarimet në DPFN-në e vitit 2003 dhe DPV-në e vitit 2004 subjekti ka deklaruar se nga dokumentet që ai ka parë në dosje deklarimet e tij kanë filluar që nga viti 2005, nuk qëndron dhe bie në kundërshtim me provat dhe faktet. Nga dokumentet e administruara nga ILDKPKI-ja në dosjen *Vetting* rezulton se subjekti ka plotësuar në datën 18.3.2004 deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim, ku është përzgjedhur me X deklaratat e tipit “plotësuar për herë të parë” dhe jo ajo “vjetore”, ku janë deklaruar të gjitha pasuritë e krijuara përpara fillimit të detyrës, deklaratë e cila i është vënë në dispozicion subjektit pasi është paraqitur në ambientet e Komisionit për të marrë materialet e dosjes. Në këtë deklaratë nuk është përmbushur detyrimi ligjor për të deklaruar depozitën dyemërore me vjehrrën dhe burimi i saj. Edhe në DPV-në e vitit 2004, të plotësuar nga subjekti në datën 24.3.2005, nuk është përmbushur detyrimi ligjor për të deklaruar pakësimin e depozitës. Në vijim të seancës, pasi i është bërë me dije se i ka plotësuar dhe dorëzuar të dyja deklaratat, subjekti është shprehur në mënyrë kontradiktore se mosdeklarimi ka qenë për shkak të pakujdesisë dhe neglizhencës në plotësimin e deklaratave.

- Për sa i përket pretendimit se emri i subjektit në llogarinë dyemërore është vendosur për arsye administrative pasi nëse do të kishte nevojë për lëvizje, vjehri, vjehrra dhe bashkëshortja e tij nuk do të kishin mundësi të vinin nga Peshkopia në Tiranë, është i pabesueshëm, në kushtet kur në periudhën e hapjes së depozitës në vitin 2001 edhe vetë subjekti banonte në Peshkopi ku ishte në marrëdhënie pune për shkak se ushtronte detyrën si gjyqtar, dhe akoma nuk kishte lëvizur me punë në Tiranë ku ishte çelur depozita (lëvizja për në Durrës në Avokaturën e Shtetit është bërë 2 vite më pas). Kështu, në vitin 2001, kur të gjithë banonin në Peshkopi, depozita mund të çelej në një bankë të nivelit të dytë në qytetin e Peshkopisë nga vjehri dhe subjektit (akoma të rinj në moshë), të cilët mund t'i kryenin vetë veprimet bankare.

- Në kushtet kur subjekti në parashtrime ka deklaruar se si depozitimet dhe tërheqjet janë kryer nga të dy personat bashkëmbajtës të llogarisë, pra vjehra e tij ka qenë e pranishme sa herë janë kryer veprime bankare, mbetet e paqartë përse depozita e pretenduar në pronësi të vjehërrve është çelur dhe mbyllur nga subjekti dhe kryerja e veprimeve bankare është bërë prej tij dhe jo nga vjehra e tij. Për më tepër, sikurse është arsyetuar më sipër, nuk ka ndonjë provë që të vërtetojë përdorimin e shumës 23,000 USD nga vjehri i subjektit për blerjen e pasurisë në Durrës. Mandatpagesa e kryer pas 4 ditësh prej 15,000 euro, bashkëlidhur kontratës për blerjen e pasurisë në Durrës nga vjehri i subjektit, vërteton kryerjen e kësaj pagese, por jo burimin e saj.

- Deklarata e subjektit në deklaratën *Vetting* se “Unë jam futur në këtë depozitë vetëm për të tërhequr në rast nevojë”, mbetet një deklaram i pavërtetë, në kushtet kur subjekti nuk ka kryer vetëm tërheqje, por edhe depozitime vlerash monetare, duke qene i vetmi që ka vepruar në llogari. Edhe deklarimi i dhënë në seancë dëgjimore se ai ishte vetëm shoqërues i vjehrrës për arsye të sigurisë së vlerave monetare nuk qëndron, pasi *de jure* ai ishte i legjitimuar si bashkëpronar i kësaj llogarie. Gjithashtu, deklaramet e subjektit gjatë hetimit janë kontradiktore, pasi në përgjigje të pyetësorëve ai ka deklaruar se veprimet bankare janë kryer të gjitha prej tij për arsyen se vjehrrit jetonin në Peshkopi e nuk vinin dot në Tiranë, ndërsa në parashtrime dhe në seancë ka deklaruar se çdo veprim bankar është kryer nga të dy personat bashkëmbajtës të llogarisë.

20.17. Bazuar në të gjitha rrethanat më sipër, për sa kohë vjehrrit e subjektit nuk kanë justifikuar me të ardhurat e tyre të ligjshme depozitimet në llogarinë bankare dhe për sa kohë subjekti në mënyrë të pajustificuar ka qenë i vetmi që ka kryer veprimet bankare në periudhën kur ka qenë në detyrën e gjyqtarit, subjekti nuk arriti të bindë Komisionin për pronësinë e vjehërrve mbi depozitën objekt vlerësimi, duke mos hedhur poshtë dyshimet e arsyeshme për një pasuri të fshehtë të tij mbi depozitën dyemërore, e cila mund të jetë përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, në të cilin subjekti është sjellë si pronar (trajtuar në vijim). Pavarësisht sa më sipër, në përfundim të procesit, për efekt të analizës financiare dhe në një qëndrim garantist ndaj subjektit, Komisioni vlerësoi që të konsiderohej ½ e depozitës si pasuri të subjektit dhe ½ si pasuri të vjehërrve, dhe nga analiza financiare e rishikuar rezultoi se të dyja palët nuk kanë justifikuar me të ardhura të ligjshme pjesët përkatëse.

20.18. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, nga Komisioni vlerësohet se mospërbushja e detyrimit ligjor për deklarimin e depozitës në DPFD-në e vitit 2003 si bashkëmbajtës i llogarisë dyemërore, e cila passjell edhe detyrimin ligjor për të vërtetuar burimet e ligjshme, detyrim të cilin subjekti nuk arriti ta përmbushë, si dhe mosdeklarimi i pakësimit të saj për shkak të mbylljes në DPV-në e vitit 2004, shoqëruar me deklarimet kontradiktore, në disa raste të pavërteta e jo në përputhje me provat e administruara, në përpjekje për të justifikuar këto mosdeklarime, çmohen si përpjekje të subjektit për ta fshehur depozitën në DPFD-në e vitit 2003 dhe DPV-në e vitit 2004 dhe e vënë atë në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për shkak të deklarimeve të pasakta e të pamjaftueshme, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Deklarimi i depozitës bankare në deklaratën *Vetting*, ku nuk është deklaruar sipas ligjit burimi i të ardhurave për krijimin e saj dhe nuk janë paraqitur dokumente justifikuese për të vërtetuar burimet, çmohet se është bërë vetëm për efekt të procesit të rivlerësimit dhe nuk e përjashton subjektin nga përgjegjësia ligjore.

21. *Llogari depozite në Raiffeisen Bank sh.a., në të cilën kam depozituar me kontratë depozite me afat shumë prej 550,000 lekësh. Kjo shumë është përfituar nga kursimet e pagave në vite të miat dhe të bashkëshortes. Zotërues 100%. Burimi i krijimit: nga kursimet e pagave në vite të miat dhe bashkëshortes.* ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

Nga hetimi administrativ rezultoi se me kontratë depozitë të lidhur në datën 27.1.2017 pranë Raiffeisen Bank sh.a., është depozituar shuma 550,000 lekë, me afat 12 muaj. Raiffeisen Bank konfirmon depozitë në emër të z. Saimir Nazifi, me gjendje në datën 30.1.2017, në vlerën 550,000 lekë. Nga veprimet bankare rezulton se në datën 27.1.2017 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e tij shumë 550,000 lekë dhe në po të njëjtën ditë i ka kaluar ato në depozitë 1-vjeçare. Burimi i krijimit të kësaj depozite është trajtuar në pikën e mëposhtme. Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë depozitë bankare. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e depozituar nga banka.

22. Disponoj në banesë shumën cash prej 1,450,000 lekësh të përfitur nga kursimet nga pagat në vite të miat dhe të bashkëshortes. Zotërues 50%. Burimi i krijimit: nga kursimet e pagave në vite të mijat dhe bashkëshortes. ILDKPKI-ja ka konstatuar problematika në lidhje me gjendjen cash, pasi referuar deklaratave që subjekti ka bërë ndër vite, rezulton me një gjendje cash deri në fund të vitit 2016 në një shumë totale prej 4,350,000 lekësh, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* deklararon të ketë në banesë një gjendje cash prej 1,450,000 lekësh.

22.1. Komisioni, bazuar në deklaratat periodike, kreu analizën e ecurisë së likuiditeteve cash ndër vite, shtesave/pakësimeve, me qëllim verifikimin e gjendjes së likuiditeteve në cash në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* dhe mundësisë financiare të subjektit për të krijuar këto likuiditete. Nga leximi i deklaratave periodike rezulton se gjendja cash në datën 31.12.2016 është në shumën 4,350,000 lekë, ndërsa gjendja e deklaruar në deklaratën *Vetting* në datën 30.1.2017 është 1,450,000 lekë. Në DPV-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar: “Shtuar në llogarinë Raiffeisen Bank shumën 550,000 lekë, krijuar nga kursimet e mbajtura në shtëpi ndër vite (të deklaruar në deklaratat përkatëse ndër vite). Shumë e depozituar me kontratë depozite me afat në janar të vitit 2017”. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar edhe: “Pakësim të kursimeve në shumën 550,000 lekë, të mbajtura në shtëpi ndër vite (të deklaruar në deklaratat përkatëse), kaluar në llogarinë bankare”. Është konstatuar se për periudhën 31.12.2016 – 30.1.2017 e vetmja pasuri e krijuar dhe e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit me burim kursimet e mbajtura në shtëpi është depozita bankare prej 550,000 lekësh. Në vijim të leximit të deklaratës për vitin 2017, duket se gjendja cash në datën 30.1.2017 pas depozitimit të shumës 550,000 lekë në Raiffeisen Bank është 3,800,000 lekë (4,350,000 – 550,000) dhe jo 1,450,000 lekë, sikundër deklaroi subjekti në deklaratën *Vetting*.

22.2. Në lidhje me ligjshmërinë e kursimeve, Komisioni kreu analizën financiare për të gjithë periudhën e hetimit, nga ku kanë rezultuar me balanca negative vitet 2011, 2013 – 2015, për të cilën subjektit iu kalua barra e provës (shih analizën financiare për të gjithë periudhën e hetimit).

22.3. Në përfundim të hetimit, duket se deklarimi i subjektit në lidhje me gjendjen cash në deklaratën *Vetting* nuk përputhet me gjendjen e deklaruar në deklaratat periodike. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të vërtetojë se nuk ndodhet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke dhënë sqarime në lidhje me destinacionin e përdorimit të shumës 2,350,000 lekë (4,350,000 lekë – 550,000 lekë – 1,450,000 lekë).

22.4. Në prapësimet e tij, në lidhje me gjendjen cash të mbartur ndër vite, subjekti ka parashtruar se:

- Deklarimet e tij në vite për tepricën janë kryer me logjikën e të ardhurave dhe shpenzimeve brenda një viti. Asnjëherë nuk është deklaruar shuma totale e gjendjes cash në shtëpi, sepse nuk kërkohet deri me ndryshimet ligjore të vitit 2014. Pas këtyre ndryshimeve të vitit 2014 në deklarimin e vitit 2016 për gjendjen cash në datën 31.12.2016, subjekti kishte detyrimin për të deklaruar totalin e shumës cash, të cilën e ka bërë në deklaratën *Vetting* në janar 2017, ku ka deklaruar: “Shtuar në llogarinë depozitë Raiffeisen Bank shuma 550,00 lekë. Ky depozitim u bë për shkak të kalimit të limitit të mbajtjes në shtëpi të kursimeve cash, të parashikuar nga neni 4/1 i ligjit nr. 9049 “Mbi deklarimin...”.

- Në procesverbalin e datës 20.6.2016 në ILKDPKI ka deklaruar se: “Gjendja e cash-it në shtëpi është 1,700,000 lekë” (procesverbal i vendosur bashkëlidhur).

- Me kursimet e vitit 2016 prej 300,000 lekësh, meqenëse shuma kishte tejkaluar vlerën e lejuar nga ligji (sasia e parave cash në shtëpi, të pashpenzuar nga ana e subjektit ishte në shumën

2,000,000 lekë), në janar të vitit 2017 ka depozituar në bankë shumën 550,000 lekë dhe shuma 1,450,000 lekë është mbajtur gjendje *cash* në shtëpi.

- Diferenca me totalin që llogaritet në raportin financiar duke kryer mbledhje mekanike në vite është shpenzuar për shpenzime, për të cilat nuk janë deklaruar arsyet, sepse nuk ishin në shumën mbi 500,000 lekë deri në vitin 2014 dhe 300,000 lekë në ndryshimet e vitit 2014, për të cilat kërkohej deklarim (p.sh. pushime, ndihmë prindërve, etj.).

- Llogaritjet e gjendjes *cash* në shtëpi janë ato të procesverbalit në ILKDPKI dhe deklaratën *Vetting*.

Subjekti ka theksuar se në këtë këndvështrim, *këto shpjegime të dhëna nga e kaluara e tij në funksion të sqarimit të pasaktësive në plotësimin e deklaratave periodike të tij përpara institucionit të vetëm përgjegjës për deklarimin e pasurive, nuk mund të abstrahohen dhe konsiderohen inekzistente, si akte që japin informacion relevant për çështjet e procesit të tij të rivlerësimit. Mbi të gjitha, krijimi i tyre i provuar jashtë kontekstit të procesit të rivlerësimit dhe disa kohë përpara procesit të rivlerësimit dhe në mungesë edhe teorike, jo vetëm praktike, të qëllimit të subjektit për të deformuar veprimtarinë hetimore për vlerësimin e pasurisë sipas këtij procesi, u japin këtyre deklaratimeve kredibilitetin e nevojshëm për t'u përdorur në analizën që trupa gjyqësore vlerëson të bëjë për sasinë e parasë *cash* në shtëpi.*

22.5. Në analizë të parashtrimeve, pavarësisht se subjekti nuk është shumë i qartë në deklaratimet në lidhje me detyrimin ligjor për deklarimet e likuiditeteve në *cash*, Komisioni mban në konsideratë faktin se në deklaratat periodike ai ka deklaruar shprehimisht termin “kursime”, duke nënkuptuar në këtë mënyrë se vlerat e deklaruara janë shuma monetare të mbetura nga të ardhurat pasi janë hequr shpenzimet.

Sa i takon procesverbalit të datës 20.6.2016 mbajtur nga ILKDPKI, kur subjekti është pyetur në lidhje me gjendjen *cash* në datën 31.12.2015 dhe ku ka deklaruar shumën prej 1,700,000 lekësh, u konstatua se ky dokument që subjekti ka paraqitur në parashtrime nuk vërtetohet që të jetë lëshuar nga institucioni në rrugë zyrtare, ndërkohë që subjekti e ka pasur të gjithë kohën dhe mundësinë që ta kërkonte dokumentin në formën e duhur ligjore. Megjithatë, në një qëndrim garantist ndaj subjektit, edhe pse me rezervë, Komisioni vlerësoi të mirëqenë faktin se ky procesverbal është përpiluar me kërkesë të ILKDPKI-së, dhe se gjendja e likuiditetit në *cash* në datën 31.12.2015 ka qene në vlerën 1,700,000 lekë, qe është në të njëjtën vijë logjike me ndryshimet e ndodhura në DPV-në e vitit 2016 deri në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* në datën 30.1.2017, ku gjendja *cash* e deklaruar është 1,450,000 lekë.

Në përfundim, në analizën financiare te rishikuar Komisioni pasqyroj gjendjen *cash* sipas deklaratimeve periodike ndër vite, me përjashtim të vitit 2015 ku likuiditeti në *cash* është konsideruar në vlerën 1,700,000 lekë sipas procesverbalit të datës 20.6.2016.

23. *E drejta e bashkëpërdorimit (banimit) apartament banimi me sipërfaqe 67.6 m², të ndodhur në rrugën “****”, nd. ****, hyrja ****, ap. ****, Tiranë. (Pallati ka hyrjen nga rruga “****”). Ky apartament është në emër të bashkëshortes time M. N., të cilën e ka përfituar me kontratën e dhurimit nr. **** kol., nr. **** kol., datë 6.2.2014, të blerë nga prindërit e saj M. dhe L. K. me kontratën e shitjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë 4.1.2006, nga shoqëria “****” sh.p.k. Zotërues 0% subjekti. Burimi i krijimit: dhuratë nga prindërit e bashkëshortes për bashkëshorten e subjektit. ILKDPKI-ja ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar të vjehrrit për blerjen e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të.*

23.1. Në lidhje me mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, nga aktet në dosje rezultoi se:

- Sipas certifikatës së pronësisë datë 3.10.2005 dhe kartelës së pasurisë rezulton në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. e regjistruar pasuria nr. ***, apartament me sip. 67.6 m², në adresën rruga “****”, shk. ***, kati ***, ap. ***, Tiranë.

- Sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2006, kjo pasuri i është shitur z. M. K. (vjehtëri i subjektit) kundrejt çmimit 21,632 euro, i likuiduar. Bazuar në udhëzimin nr. 5, datë 7.9.2006, të EKB-së, çmimi referencë i shitjes për metër katror në qytetin e Tiranës në vitin 2006 ka qenë në vlerën 79,615 lekë, rrjedhimisht kjo pasuri do të duhej të ishte blerë nga vjehtëri i subjektit në vlerën 5,381,974 lekë (79,615 lekë/m² x 67.6 m²), ose e konvertuar në 43,508 euro. Duket se çmimi i blerjes së kësaj pasurie është sa ½ e çmimit referencë të EKB-së, duke ngritur dyshime se çmimi i vendosur në kontratën e shitjes është fiktiv. Subjektit ju kërkua të japë shpjegime e të paraqesë kontrata të ngjashme.

- Kjo pronë është regjistruar në emër të z. M. K., referuar certifikatës së pronësisë lëshuar në datën 5.7.2007. Sipas kartelës së pasurisë në datën 30.9.2011 kjo pasuri është rivlerësuar në vlerën 7,436,000 lekë.

- Me kontratën e dhurimit të pasurisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.2.2014, kjo pasuri i është dhuruar bashkëshortes së subjektit, znj. M. N., pa kundërshtim nga babai i saj, z. M. K.

- Me shkresën kthim përgjigjeje të ZVRPP-së Tiranë me nr. *** prot., datë 20.2.2018, konfirmohet se në emër të znj. M. N. është regjistruar pasuria nr. ***, e llojit apartament me sip. 67.6 m².

- Nëpërmjet kontratës së shitjes me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.2.2021, paraqitur në përgjigje të pyetësorit standard, M. N. në cilësinë e shitëses dhe Saimir Nazifi në cilësinë e dhënësit të pëlqimit i shesin shtetasve M. dhe A. Sh.pasurinë nr. *** kundrejt çmimit 9,268,500 lekë/75,000 euro. Nëpërmjet deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2021, palët kanë deklaruar se është shlyer e plotë vlera e çmimit të apartamentit, ndërsa nëpërmjet deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2021, pala shitëse ka deklaruar se i ka bërë palës blerëse dorëzimin fizik të apartamentit bashkë me çelësat dhe kontratat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike.

23.2. Sa i takon përdorimit të kësaj pasurie, u konstatua se:

- Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se për periudhën 11.10.2003 – 30.8.2021 ka jetuar në adresën: Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, në pronësi të vjehtërit të tij, që më pas ia ka dhuruar bashkëshortes së tij, ku kanë banuar pa pagesë. Duke qenë se vjehtëri i subjektit ka fituar pronësinë në vitin 2006, u pyet subjekti në lidhje me legjitimitimin e tij për të banuar në këtë apartament që në vitin 2003.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se banimi i tij në apartamentin e vjehtërit, pasuria nr. ***, ka filluar që nga data 11.10.2004 dhe jo 11.10.2003 (sipas tij, ka qenë një lapsus në hedhjen e shifrave në pyetësorin nr. 1 pasi duhej shënuar viti 2004 dhe jo 2003). Subjekti sqaron se nga data 16.4.2003 (ditë kur u emërua avokat në Avokaturën e Shtetit) dhe deri më 10.10.2004 ka banuar në adresën e deklaruar: Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, Tiranë, në apartamentin tjetër në pronësi të vjehtërit të tij, z. M. K., blerë në vitin 1999 dhe ka vënë në dispozicion fotokopjen e kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.5.1999 me të cilën vjehtëri i tij e ka blerë këtë shtëpi, apartament, në të cilin aktualisht jeton vjehtëra e subjektit, znj. L. K.

Në përgjigje të po këtij pyetësori, ai ka theksuar se pallati ku ndodhet pasuria nr. *** ka mbaruar në vitin 2004, por leja e shfrytëzimit është marrë në vitin 2005. Menjëherë sapo ka dalë leja e

shfrytëzimit dhe është regjistruar pronësia në hipotekë në fund të vitit 2005 në emër të shoqërisë, është lidhur kontrata e shitjes nga kompania ndërtuese tek z. M. K. në vitin 2006. Subjekti ka vënë në dispozicion fotokopje të: (i) aktit të kolaudimit të pallatit në datën 29.9.2004 (me akt kolaudimi kuptohet përfundimi së ndërtuari i pallatit, pra i gatshëm për banim nga banorët); (ii) lejes së shfrytëzimit me datë 27.1.2005.

Siç vërehet, subjekti pranon se ka filluar të përdorë apartamentin që në vitin 2004, por është i paqartë në deklarime në lidhje me faktin përse dhe si ka filluar ta përdorë që në vitin 2004, menjëherë pasi ka përfunduar ndërtimi i pallatit, ndërkohë që vjehri i tij e ka fituar pronësinë në vitin 2006.

- U kërkuan të dhëna në lidhje me kontratën e energjisë elektrike nr. *** dhe kontratën e furnizimit me ujë nr. ***, sipas librezave të paraqitura nga subjekti në pyetësin standard. FSHU-ja informon se kontrata nr. ***, me kod klienti ***, i përket abonentit A. Sh. (blerësi i pasurisë në vitin 2021) dhe është hapur në datën 9.10.2004 nga Saimir Nazifi. UKT-ja informon se për hapjen e kontratës nr. *** dhe nga kontrolli në arkivin e saj disponojnë regjistër të kontraktuesve që prej vitit 2004, ku rezulton se kjo kontratë është regjistruar në emër të z. Saimir Nazifi, për objektin pallat, me adresë rruga “D. H.”. Bashkëlidhur kësaj shkresë gjendet fleta e regjistrit e majit të vitit 2004.

- Në lidhje me një konflikt të mundshëm interesi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër informon se subjekti nuk ka gjykuar çështje gjatë kohës që ka qenë gjyqtar në këtë gjykatë, me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe administratorin e shoqërisë, z. I. M.

23.3. Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar të vjehrit për blerjen e këtij apartamenti në rrugën “****”, Tiranë, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- I është dërguar shkresë shoqërisë të vërtetojë me dokumente shkresore nga kush dhe si është likuiduar çmimi i shitjes, e cila në kthim përgjigjen ka vënë në dispozicion kopjen e kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2006 dhe informon se blerësi M. K. vlerën e apartamentit prej 21,632 euro e ka likuiduar *cash* të ndarë me këste, por për shkak se kanë kaluar 18 vite ata i nuk disponojnë më mandatet e pagesave.

- I është kërkuar informacion subjektit, i cili në përgjigje të pyetësit nr. 2 nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me mënyrën si vjehri i tij ka likuiduar çmimin e blerjes (ndërkohë, pa iu kërkuar ka dhënë sqarime në lidhje me mënyrën e likuidimit nga blerësi të çmimit të shitjes së pasurisë në vitin 2021 kur ka shitur pasurinë).

- Në lidhje me të ardhurat e ligjshme të vjehrit dhe vjehrrës për blerjen e apartamentit, subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka depozituar akte shkresore dhe të ardhurat e ligjshme të dokumentuara janë përfshirë në analizën financiare të prindërve të bashkëshortes.

- ISSH-ja me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.2.2022, informon në lidhje me punësimin e shtetasit M. K. pas vitit 2012.

- Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë me shkresën kthim përgjigjeje informon në lidhje me të ardhurat e përfituara nga punësimi dhe pensioni nga shtetasi M. K. për periudhën 1.1.1994 – 31.3.2020 dhe të ardhurat e përfituara nga pensioni për shtetasen L. K. nga data 5.3.2005 e në vijim.

23.4. Analiza e treguesve financiarë

Duke qenë se u vërtetua që pasuria është përdorur që në vitin 2004, është verifikuar fillimisht mundësia e blerjes së apartamentit në rrugën “****” nga vjeçrit e subjektit në vitin 2004. Në analizën financiare të paraqitur në tabelën si më poshtë për periudhën 26.9.2002 – 2004 janë konsideruar të ardhurat nga punësimi i vjeçrit të subjektit, si dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive, për të cilat është depozituar dokumentacion, ndërsa shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së. Në këtë analizë nuk janë përfshirë likuiditetet nga depozita dyemërore e subjektit me shtetasen L. K. , duke qenë se nuk u provua burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj depozite dhe për këtë arsye analiza financiare është kryer e fragmentuar, duke përfshirë të ardhurat nga data 26.9.2002 deri në vitin 2004.

Përshkrimi	26.9.2002 – 2004
Pasuritë	4,792,740
Ap. *** m ² , nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, ***, Durrës, 2004 – 2005	1,901,100
Ap. 67.6 m ² , nd. ***, h. ***, ap. ***, nr. pasurie ***, z. k. ***, rruga “****”, 2004	2,741,640
Automjet tip “Volkswagen Golf” me targë ***, blerë më 26.9.2003	150,000
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	0
Likuiditete në banka	
<i>Cash deklaruar në DPV</i>	
Gjendja e likuiditeteve	0
Detyrime	0
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	4,792,740
Të ardhurat	2,874,689
Të ardhura M. K. 1994 – 2004	624,689
Të ardhurat nga aktiviteti L. K. 1994 – 2004	0
Të ardhurat nga shitja e ap. nr. ***, p. ***, shk. ***, k. ***, Dibër, 21.8.1995	0
Të ardhurat nga shitja e ap. p. ***, k. *** lagjja “****” 29.6.2003	1,000,000
Të ardhurat nga shitja e dyqanit 2003	1,000,000
Të ardhurat nga shitja e shtëpisë private 1/2 në vitin 2002	0
Të ardhurat nga shitja e mjetit tip “Golf”, 5.11.2003	250,000
Shpenzimet	422,803
Shpenzime jetike	422,803
Mundësia për kursime	-2,340,854

Nga analiza financiare duket se prindërit e bashkëshortes së subjektit nuk kanë pasur mundësi financiare për të paguar çmimin e apartamentit në rrugën “****” në vitin 2004, apartament i cili është përdorur pa ndërprerje nga subjekti i rivlerësimit, pasi kanë rezultuar me një balancë negative prej 2,340,854 lekësh.

Nëse do të konsiderohet se çmimi është paguar në vitin 2006 sipas kontratës së shitjes, vjeçri nuk ka pasur mundësi pagese me të ardhura të ligjshme, pasi deri në momentin e blerjes në datën 4.1.2006, analiza financiare ka rezultuar me mungesë burimesh në shumën 3,521,303 lekë.

Përshkrimi	26.9.2002 – 2005
Pasuritë	6,011,790
Ap. 46.7 m ² , nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, ***, Durrës, 2004 – 2005	2,820,150
Ap. 67.6 m ² , nd. ***, h. ***, ap. ***, nr. pasurie ***, z. k. ***, rruga “****”, 2004	2,741,640
Automjet tip “Volkswagen Golf” me targë ***, blerë më 26.9.2003	150,000
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	300,000

Likuiditete në banka	300,000
Cash deklaruar në DPV	
Gjendja e likuiditeteve	
Detyrime	0
Pasuri net (pasuri - detyrime)	6,011,790
Të ardhurat	3,132,403
Të ardhura M. K. 1994 – 2004	814,731
Të ardhurat nga pensioni L. K. 2005 – 2016	67,672
Të ardhurat nga aktiviteti L. K. 1994 – 2004	0
Të ardhurat nga shitja e ap. p. ***, k. ***, lagjja “****” 29.6.2003	1,000,000
Të ardhurat nga shitja e dyqanit, viti 2003	1,000,000
Të ardhurat nga shitja e shtëpisë private 1/2 në vitin 2002	0
Të ardhurat nga shitja e mjetit tip “Golf”, 5.11.2003	250,000
Shpenzimet	641,917
Shpenzime jetike	641,917
Mundësia për kursime	-3,521,303

23.5. Në lidhje me mobilimin e apartamentit, në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se apartamenti që ai ka jetuar deri më 31.8.2021 është rinovuar nga ana e tij në vitet 2006 dhe 2007 (megjithëse kishte 3 vite që jetonte pasi ishte kompletuar nga vjehri) dhe më pas janë blerë pajisje edhe në vitet e tjera. Ai ka vënë në dispozicion deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.8.2021 të administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., identifikuar me NIPT ***, z. F. S., ku ai deklaron se në vitet 2006 dhe vitin 2007 z. Saimir Nazifi ka porositur mobiliet që ka listuar në këtë deklaratë dhe ka bërë pagesën *cash* të tyre në arkën e shoqërisë për mobilimin e shtëpisë ku ka jetuar deri më 31.8.2021.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se në tetor të vitit 2004, në kohën kur ai është futur në shtëpinë e vjehrit, i cili ka qenë një apartament i ri i mobiluar shumë pak nga vjehri, ai ka sjellë pajisjet dhe mobiliet nga Peshkopia. Në vitet 2006 dhe 2007, për shkak të rritjes së vajzave, ka kryer një rimobilim pjesor, për të cilin ka paraqitur edhe tabelën e mëposhtme, dorëzuar në përgjigje të pyetësorit të parë, e cila përmban informacionin e plotë për të gjithë rinovimet e kryera në këtë apartament.

	Pajisje/mobilie	Vlera/lekë	Ku është blerë	Viti	Dokument
1	Kundrabufe	140.000	*** sh.p.k	2006	Deklaratë
2	Kënd për dhomë ndenjeje	80.000	*** sh.p.k	2006	Deklaratë
3	Dhomë gjumi të vajzave	85.000	*** sh.p.k	2007	Deklaratë
4	Krevat dopio	45.000	*** sh.p.k	2007	Deklaratë
5	Dollap i madh dhomë gjumi	57.000	*** sh.p.k	2007	Deklaratë
6	Portmanto	25.000	*** sh.p.k	2007	Deklaratë
7	Aksesore të kundrabufesë (soba, lavapjata).	70.000	*** sh.p.k	2006	Deklaratë
8	Tavolinë TV	25.000	*** sh.p.k	2006	Deklaratë
9	Frigorifer i brendshëm	70.000	*** sh.p.k	2006	Deklaratë
10	Tavolinë studimi dhe kompjuteri	25.000	*** sh.p.k	2007	Deklaratë
11	TV	100,000	***	2011	Kredi
12	Kondicioner	65.000	***	2017	Cash

Pra, sikurse ka sqaruar vetë subjekti, rimobilimi i shtëpisë është kryer në vitet 2006 dhe 2007, TV është marrë me kredi në vitin 2011, kondicioneri është blerë duke e paguar *cash* në vitin 2017, ndërsa mobiliet dhe pajisjet e tjera janë blerë tek shoqëria “****” sh.p.k., për të cilën ai ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.8.2021. Shpenzimet e mobilimit janë përfshirë në analizën financiare sipas deklarimeve të subjektit.

23.6. Në përfundim të hetimit administrativ, janë ngritur dyshime se pasuria objekt verifikimi ka qenë në pronësi të subjektit dhe vetëm formalisht kontrata e shitjes me datë 4.1.2006 është lidhur në emër të vjehrrit. Për të arritur në këtë konstatim Komisioni i është referuar rrethanave si vijojnë:

- Blerja e pasurisë nga vjehri i subjektit është bërë në vitin 2006, periudhë në të cilën ai ka pasur një apartament tjetër në Tiranë të blerë që në vitin 1999, ku ka banuar me bashkëshorten që kur janë transferuar nga Peshkopia dhe në vijim.

- Sikurse subjekti deklaron, ai ka filluar të përdorë apartamentin që në vitin 2004 kur ka përfunduar ndërtimi i pallatit, ndërkohë që në datën 9.10.2004 është lidhur kontrata e energjisë elektrike në emër të tij dhe në maj të vitit 2004 është lidhur kontrata e furnizimit me ujë po në emër të tij. Në mënyrë të palegjitimuar dhe të paqartë subjekti ka përdorur pasurinë që nga viti 2004 kur kanë përfunduar punimet, pra 2 vite më parë se të jetë lidhur kontrata e shitjes së pasurisë në emër të vjehrrit.

- Subjekti ka përdorur pa ndërprerje dhe pa kundërshtim pasurinë që nga viti 2004 deri në vitin 2014, kur bashkëshortja e tij është bërë pronare me dhurim nga babai, dhe në vijim, deri në vitin 2021, kur e ka shitur pasurinë. Ndërsa vjehrrit e subjektit nuk e kanë përdorur asnjëherë pasurinë.

- Në DPV-në e vitit 2004 deri në deklarin për vitin 2013, subjekti nuk ka deklaruar të drejtën reale të përdorimit mbi këtë pasuri, ndonëse ka deklaruar adresën e banimit.

- Subjekti nuk ka qartësuar dhe vërtetuar në deklarinimet e tij gjatë procesit mënyrën dhe periudhën kur është bërë likuidimi i çmimit të blerjes së këtij apartamenti nga vjehri i tij dhe as mënyrën si e ka përdorur pasurinë që në vitin 2004.

- Tërheqja nga subjekti e vlerës 23,307.54 USD në datën 26.11.2004 nga llogaria dyemërore me vjehrrën dhe për të cilën janë ngritur dyshime se mund të ketë qenë e subjektit të rivlerësimit, përkon me periudhën që vetë subjekti ka filluar të përdorë apartamentin në vitin 2004, e në këto kushte ngrihen dyshime që pagesa e këtij apartamenti mund të jetë kryer që në vitin 2004 nga subjekti me vlerat monetare të depozitës bankare dyemërore me vjehrrën.

- Prindërit e bashkëshortes nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të blerë pasurinë me çmimin 21,632 euro, i cili është sa ½ e çmimit referencë të EKB-së, duke u ngritur dyshime se çmimi i vendosur në kontratën e shitjes mund të jetë fiktiv.

Për të gjitha këto arsye, në përfundim të hetimit administrativ, çmimi i paguar për blerjen e pasurisë është konsideruar si shpenzim i subjektit në vitin 2006 (referuar kontratës së shitjes).

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë shpjegime e dokumente shkresore në lidhje me konstatimet si më sipër dhe të vërtetojë se nuk ndodhet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

23.7. Në prapësimet e tij subjekti ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit, duke pretenduar se:

- Pa të drejtë të gjitha llogaritjet janë kryer duke i ngarkuar atij shpenzimet për investimin në këtë pasuri e duke këmbëngulur që pasuria është blerë nga vjehri i tij e më pas i është dhuruar bashkëshortes së tij. Subjekti ka deklaruar se kontrata e blerjes së shtëpisë është lidhur në vitin 2006, por prenotimi i apartamentit është bërë që në vitin 2003 nga vjehri, por nuk ka paraqitur ndonjë dokument për të vërtetuar këtë deklaram. Subjekti vijon të deklarojë se apartamenti është përdorur nga ana e tij që në vjeshtë të vitit 2004 dhe se z. M. ka pasur jo 1, por 2 apartamente të tjera kur ka prenotuar apartamentin të cilin ia ka dhuruar bashkëshortes së tij: shtëpinë ku jeton edhe sot shtetasja L. K. , që e kishte blerë që në vitin 1999 dhe shtëpinë në Allias që ia kishte dhënë në përdorim vajzës tjetër Nelda Kodra për banim e klinikë, të cilën e kishte blerë që në vitin 2001. Subjekti argumenton se z. Kodra kishte menduar që 2 vajzave t'u dhuronte nga një apartament dhe meqenëse vajza tjetër e tij Nelda kishte marrë apartamentin në *** të blerë në vitin 2001, apartamentin që kishte prenotuar ia premtoi bashkëshortes së subjektit. Pra, z. M. K. u ka dhuruar 2 vajzave nga një apartament, të cilët në momentin e dhurimit kanë pasur pothuajse vlerë të barabartë dhe të dyja veprimet janë kryer në vitin 2014.

- Për sa i takon dyshimeve të ngritura nga Komisioni në lidhje me çmimin në kontratën e shitjes, subjekti parashtron se të gjithë banorët kanë prenotuar në vitin 2003 tek shoqëria “****” sh.p.k., por kontratat i kanë bërë në vitet 2005, 2006 dhe 2007 kur kanë hyrë në apartamente dhe se çmimi i kontratave ka qenë pothuajse i njëjtë, 320 euro/m². Për këtë subjekti ka depozituar dy kontrata shitjeje⁶, në të cilat pasqyrohet çmimi prej 320 euro/m². Gjithashtu, subjekti ka theksuar se kështu e apartamentit janë dhënë gjatë vitit 2003, por pa e vërtetuar këtë fakt me ndonjë dokument shkresor dhe se çmimet e apartamenteve në qytetin e Tiranës janë rritur shumë në vitin 2004, pas daljes së një udhëzimi të përbashkët të DPT-së dhe EKB-së.

- Subjekti parashtron se kontratën e energjisë dhe të ujësjetillësit i ka hapur ai në vitin 2004, për arsye se pallati ishte në përfundim e sipër dhe meqenëse z. K. nuk ishte akoma në Tiranë në këtë apartament do banonte vetë subjekti. Për sa i takon konstatimit se z. M. nuk e ka përdorur apartamentin të cilin ia ka dhuruar bashkëshortes së subjektit, ai ka sqaruar se nuk ka përdorur asnjë ditë as apartamentin që i ka dhuruar vajzës tjetër N. K. Pra, në të dyja apartamentet (që ai më pas ua ka dhuruar vajzave) ka përdorur të njëjtin standard – nuk ka jetuar në to. Subjekti ka theksuar se në deklaramet që ka bërë në ILKDPKI ai gjithmonë ka deklaruar se ka jetuar pa kundërshtpërblim në këtë adresë në pronësi të shtetasit M. K. (bashkëlidhur ka vendosur procesverbalin e mbajtur në datën 20.6.2016 nga ILKDPKI-ja, i pa vërtetuar në rrugë zyrtare).

- Për sa i takon konstatimit se subjekti nuk ka qartësuar dhe deklaruar mënyrën e likuidimit të çmimit të apartamentit nga vjehri, ai ka theksuar se nuk ka asnjë informacion për mënyrën dhe periudhën e kryerjes së pagesave nga shtetasi M. K. për këtë apartament, ashtu siç nuk ka edhe për blerjet e apartamenteve të tjerë që vjehri i tij ka blerë në vitet 1999 dhe 2001, pasi z. M. ka ndërruar jetë. Po kështu, deklaroi se shoqëria në përgjigje zyrtare thekson se nuk disponon një informacion të tillë, si dhe ASHK-ja nuk ka të dhëna në arkiv.

- Gjithashtu, subjekti kundërshtoi dyshimet e ngritura për pronësinë e tij mbi llogarinë dyemërore me vjehrrën dhe se vlera monetare prej 23,307.54 USD e tërhequr më 26.11.2004 nga llogaria dyemërore me vjehrrën mund të jetë përdorur si pagesë për këtë apartament, pasi sipas tij është plotësisht e konfirmuar se me pjesë të kësaj shume është kryer pagesa për prenotimin e apartamentit të blerë nga vjehri i tij në ***, Durrës, pagesë e kryer vetëm 4 ditë më vonë dhe që sipas konfirmimit nga ASHK, z. M. K. në Durrës ka vetëm një pasuri, apartamentin me sip. 46 m²

⁶ Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2005, me shitës “****” sh.p.k. dhe blerës B. Gj., për blerje apartamenti me çmimin 320 euro/m²; kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.5.2007, me shitës “****” sh.p.k. dhe blerës E. M., për blerje apartamenti me çmimin 320 euro/m².

në ***, ***. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2024, të lëshuar nga znj. L. K. , e cila deklaron se paratë ishin të z. M. K.

- Në përfundim, subjekti ka pretenduar se vjehrit e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme për të blerë pasurinë, duke paraqitur disa dokumente shkresore, si deklaratë noteriale të shtetasit A. K., si dhe një *statement* bankar të BKT-së për pagesat që ai ka përfituar nga një klinikë mjekësore, të cilat nuk vërtetojnë të ardhura të tjera të ndryshme nga ato të evidentuara gjatë hetimit administrativ. Po kështu, subjekti pretendon që referuar qëndrimin të Kolegjit, duke qenë se pasuria nuk është një pasuri e fshehur e tij, Komisioni duhet të përjashtonte pasuritë e tjera të vjehërve, duke u kufizuar vetëm në vlerën e dhurimit. Nga ana tjetër, subjekti i referohet faktit që marrëdhënia me vjehrin ka qenë për një kohë të gjatë një marrëdhënie huapërdorjeje dhe në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, ai nuk duhet të kishte detyrimin për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie nga vjehri i tij. Fakti i lidhjes së mëvonshme të kontratës së dhurimit, sipas tij, nuk duhet të çojë në hamendësime mbi konsiderimin e saj si pasuri të fshehur, për sa kohë që këto hamendësime nuk kanë asnjë bazë reale dhe bien ndesh me realitetin faktik të ecurisë së veprimeve juridike të kryera nga vjehri i tij dhe gjendjen e tij pasurore. Bindja për heqjen e çdo dyshimi për konsiderimin e saj si pasuri e fshehur duhet të krijohet sipas tij edhe mbi bazën e një deduksioni të thjeshtë logjik, pasi në referim të jurisprudencës së Kolegjit, në një rast të tillë, huapërdorja nuk do të konsiderohej si marrëdhënie interesi dhe për rrjedhojë ai do të çlirohej nga barra e provës për të vërtetuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie. Në këtë kuptim, fakti që ai ngarkohet me barrë për shkak të kontratës së dhurimit, do të thotë se ky ka qenë tërësisht një veprim juridik, real dhe i vërtetë.

23.8. Në analizë të parashtrimeve, Komisioni arsyeton se:

- Është vërtetuar që subjekti ka pasur një marrëdhënie 17-vjeçare me pasurinë në pronësi të vjehrit të tij M. K., si para ashtu dhe pas plotësimit të deklaratës *Vetting*. Kolegji ka trajtuar disa çështje ku objekt vlerësimi kanë qenë pasuri në përdorim të subjekteve të rivlerësimit, ndërkohë që pronësia u përkiste prindërve të tyre, një nga të cilat është rasti i subjektit të rivlerësimit F. I.⁷, në të cilin referohen edhe raste të tjera të ngjashme të trajtuara nga ana e Kolegjit. Konkretisht, në këtë vendim⁸ arsyetohet se: *“Vlerësimin e tij lidhur me përdorimin e apartamentit të babait të subjektit pa pagesë qiraje, Kolegji e ka trajtuar në vendimin nr. 7, datë 24.6.2020, ku në paragrafin 94 të tij ka arsyetuar se: Lidhur me përdorimin prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, të apartamentit të babait të tij, z. M. K., pa pagesë qiraje, trupi gjykues, edhe pse mban në konsideratë faktin që mbështetja që i është dhënë subjektit të rivlerësimit nga babai i tij, z. M. K., si më sipër, mund të trajtohej teorikisht si një përfitim monetar (shumë e pashpenzuar për qëllime qiraje banimi) dhe, si rrjedhojë, do të mund të vendoste palët në një marrëdhënie interesi pasuror sipas parashikimeve të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se nëse gjatë kontrollit të kësaj pasurie, nuk arrihet në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasurinë (duke qenë se për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare dyshimi për konflikt të mundshëm interesi nuk ekziston), atribuimi i mungesës së burimeve të ligjshme të babait të subjektit, për të justifikuar krijimin e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 135 m² dhe dy garazhe me sip. 18 m², subjektit të rivlerësimit, në kuadër të lidhjes që ekziston mes tyre për përdorim të përbashkët të banesës, pa qira, do të tejkalonte objektin e procesit të rivlerësimit”.*

⁷ Shihni vendimin nr. 10, datë 14.4.2022.

⁸ Shihni paragrafin 14.15.

- Në vijim⁹, Kolegji është shprehur se: “Pavarësisht sa më sipër arsyetuar, Kolegji, në kuadër të parashikimit në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, vlerëson se Komisioni, lidhur me pasuritë në përdorim të subjekteve të rivlerësimit, ka detyrimin të analizojë dhe evidentojë saktë marrëdhënien juridike që lidh subjektin e rivlerësimit me pasurinë në përdorim, në drejtim të verifikimit të çdo fakti apo rrethane që mund të ngrejë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të tij, që mund të rezultojnë të jenë krijuar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në rastin objekt shqyrtimi, pavarësisht se trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka konstatuar saktë ekzistencën e një marrëdhënieje përdorimi, në kuadër të një vendimmarrjeje sa më të drejtë, pas administrimit të provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit dhe në analizë të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, vendosi të verifikojë konkluzionin e Komisionit në vendim se: subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. pasi për apartamentin me sip. 100 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, të përdorur prej tij (para dhe pas deklaratës Vetting), nuk arriti të sigurojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie”.

- Pasi ka verifikuar burimet financiare të personit të lidhur (babait të subjektit), Kolegji ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga Komisioni, sikurse është arsyetuar në paragrafin nr. 23: “Ky konkluzion i Komisionit nuk qëndron, pasi babai dhe anëtarët e familjes së tij, në kuadër të regjimit të përbashkët familjar, kanë rezultuar me mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për të paguar shumën 50.000 euro, për këtë apartament objekt analize, në datën 23.9.2010. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, Kolegji konstaton që nuk ka pasaktësi në deklaram, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016”.

- Siç vërehet në vendimin e sipërcituar, por jo vetëm, Kolegji e ka lidhur hetimin e pasurive të dhëna në përdorim nga prindërit e subjekteve me faktin nëse për pasuritë e vlerësuar ka pasur dyshime për pronësi të mundshme të fshehur të subjekteve të rivlerësimit dhe, nga ana tjetër, nuk i ka përjashtuar subjektet nga detyrimi ligjor për të vërtetuar burimin e ligjshëm të pasurisë në pronësi të personit tjetër të lidhur.

- Duke kaluar në rastin objekt vlerësimi, subjektin Saimir Nazifi, nga ana e Komisionit janë evidentuar prova e fakte që kanë ngritur dyshime të arsyeshme se pasuria ka qenë në pronësi të subjektit dhe vetëm formalisht kontrata e shitjes me datë 4.1.2006 është lidhur në emër të vjehrrit, si dhe është evidentuar se vjehrrit i tij nuk ka pasur burime të justifikuara ligjërisht për blerjen e pasurisë, konstatim i cili nuk ndryshoi edhe pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në parashtrime. Pretendimi i subjektit se analiza financiare e vjehërrve duhet të bëhet vetëm për pasurinë objekt verifikimi vlerësohet i pabazuar, për sa kohë janë ngritur dyshime për pasuri të fshehura nga subjekti, jo vetëm për këtë apartament, por edhe për një depozitë kursimi në llogari dyemërore me vjehërrin, dyshime të cilat subjekti nuk arriti t’i kundërshtojë në mënyrë bindëse, sikurse është arsyetuar në mënyrë të hollësishme në këtë vendim.

23.9. Në analizë të të gjitha provave të administruara gjatë dhe pas procesit të hetimit administrativ dhe të parashtrimeve të subjektit pas kalimit të barrës së provës, në përfundim të procesit Komisioni vlerësoi se parashtrimet e subjektit nuk kanë qenë bindëse e të nje niveli që të heqin dyshimet për një pasuri të mundshme të tij të fshehur mbi apartamentin, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

⁹ Shihni paragrafin 15.

- Subjekti ka filluar ta përdorë pasurinë e mënyrë të palegjitimuar që në vitin 2004, ndërkohë që pretendimet për prenotimin e apartamentit nga vjehri dhe pagimin e çmimit të shitjes prej tij që në vitin 2003 apo 2004 mbeten të pavërtetuara.

- Subjekti ka lidhur në emër të tij kontratën e energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë që në vitin 2004. Mosvërtetimi i prenotimit të apartamentit nga ana e vjehrit në vitin 2003/2004 me një dokument shkresor, nuk përjashton mundësinë e ekzistencës së një kontrate të tillë në emër të subjektit të rivlerësimit, mbi bazën e së cilës janë lidhur kontratat e ujit dhe energjisë elektrike. Për më tepër, subjekti ka deklaruar se vjehrit e tij kanë ardhur për të banuar në Tiranë në vitin 2004 dhe mbetet e paqartë përse kontratat nuk janë lidhur prej tij.

- Në DPV-në e vitit 2004 deri deklarimin e vitit 2013 subjekti nuk ka deklaruar të drejtën reale të përdorimit mbi këtë pasuri, ndonëse e ka deklaruar si adresë banimi. Duke qenë se pasuria nuk ka qenë thjesht një adresë banimi por vendbanimi i vetëm i subjektit ndër vite në mënyrë të pandërprerë, mungesa e deklarimeve të së drejtës reale të përdorimit dhe e burimeve të krijimit të saj, sikurse parashikon neni 4 i ligjit nr. 9049/2003, kanë vështirësuar punën e Komisionit për të kryer një vlerësim sa më objektiv të kësaj pasurie.

- Subjekti dështoi të vërtetojë pronësinë e vjehërve të tij mbi depozitën e çelur prej tij në vitin 2001 (kur ka qenë gjyqtar) në një llogari dyemërore me vjehrrën, nga të cilat vlera prej 23,307.54 USD është tërhequr më 26.11.2004 po nga subjekti i rivlerësimit, pra në të njëjtin vit kur ka filluar të përdorë apartamentin.

- Prindërit e bashkëshortes nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të blerë pasurinë me çmimin 21,632 euro.

Megjithatë, në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes, trupi gjykues, duke mbetur në kuadër të dyshimeve të arsyeshme, nuk mund të konkludojë për fshehje pasurie nga ana e subjektit, por krijoi bindjen se subjekti i cili është sjellë si pronar i apartamentit dy vite më parë se vjehri i tij ta blinte pasurinë e në vijim, ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme të kësaj pasurie, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërinë” pasi nuk arriti të vërtetojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Në analizën financiare të rishikuar, shuma e blerjes së pasurisë prej 21,632 euro nuk është konsideruar si vlerë e paguar nga subjekti i rivlerësimit, duke mos ia atribuar atij mungesën e burimeve të ligjshme të prindërve të bashkëshortes për të blerë pasurinë.

Konstatime të tjera

24. Në lidhje me adresën e banimit të subjektit të deklaruar ndër vite, rezultoi se:

- Në DPDFD-në e viteve 2003 dhe 2005 e në vijim, subjekti ka deklaruar si adresë banimi rruga “****”, Tiranë (banesa në pronësi të vjehrit), ndërsa në DPV-në e vitit 2004 ka deklaruar si adresë Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, Tiranë. Është pyetur subjekti në lidhje me këtë adresë, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se i përket apartamentit të banimit të blerë nga vjehri i tij M. K. i cili në atë kohë jetonte ende në Peshkopi, por ndërkohë kishte në pronësi 2 apartamente të blera në Tiranë në vitet 1999 dhe 2001, me adresat përkatësisht: Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, nd. *** H, ap. ***, Tiranë (blerë në 1999) dhe Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, shkolla “****”, ***, Tiranë (blerë në vitin 2001, për të cilën ka paraqitur kontratën e blerjes në vijim të përgjigjeve të pyetësorit nr. 2). Subjekti ka sqaruar se kjo adresë është dhënë vetëm për efekt deklarimi adrese si kontakt i sigurt.

25. Në lidhje me kredinë konsumatore të marrë nga subjekti në tetor të vitit 2006 në Raiffeisen Bank, në shumën 1,000,000 lekë, me afat 5-vjeçar, me këst mujor 25,400 lekë, qëllimi i dhënies së kredisë për arsye personale, në pyetësin standard subjekti ka vënë në dispozicion kontratën e kredisë bankare të marrë pranë Raiffeisen Bank në datën 25.9.2006, në shumën 1,000,000 lekë, me afat 60 muaj. Subjekti e ka deklaruar marrjen e kësaj kredie në DPV-në e vitit 2006, si dhe ka deklaruar shlyerjet e kësteve në deklaratat e ardhshme periodike në DPV-të e viteve 2008, 2009, 2010 dhe 2011. Sipas deklaramit të bërë nga subjekti në DPV-në e vitit 2011, kjo kredi është shlyer totalisht/mbyllur në tetor të vitit 2011, fakt i vërtetuar edhe me të dhënat bankare. Në analizën financiare kjo kredi është trajtuar si shpenzim, pra si shumë që subjekti e ka përdorur, por nuk dihet destinacioni. Në vitet kur subjekti ka shlyer kredinë analiza financiare ka rezultuar me balanca negative, konkretisht 2007 – 2009 dhe 2011. Subjektit iu kërkua të japë sqarime për destinacionin e kësaj kredie dhe në përgjigje me *email*-in e datës 10.5.2024 ka sqaruar se kjo kredi është marrë me qëllim rimobilimin e shtëpisë, e cila është bërë në vitet 2006 – 2007 dhe për të cilën ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.8.2021, me shoqërinë “****” sh.p.k. Në analizën financiare për vitin 2006 diferenca prej 615,000 lekësh (1,000,000 lekë kredia – 385,000 lekë shpenzime mobilimi në vitin 2006) është konsideruar si shumë e shpenzuar, pasi subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*, shumë e cila do të mund të mbartej në vitin 2007 dhe të përdorej për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit në vlerat e deklaruara nga subjekti.

26. Në lidhje me kredinë konsumatore për blerje elektroshtëpiake, e marrë në datën 27.12.2010, në shumën 100,000 lekë, me afat 2-vjeçar, me këst mujor 5,200 lekë, tribor +11%, subjekti e ka deklaruar këtë kredi në DPV-në e vitit 2010, por pa përcaktuar institucionin se ku e ka marrë. Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2011 se ka shlyer një pjesë dhe pjesën e mbetur prej 60,000 lekësh e ka shlyer në dhjetor të vitit 2012, deklaruar në DPV-në e vitit 2012, fakt i vërtetuar edhe me të dhënat bankare. Në pyetësin standard subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacionin ku tregohet se në datën 22.12.2010 ka marrë kredi me qëllim blerje televizori në Raiffeisen Bank dhe miratimin e kredisë nga shoqëria “****”, e cila ka konfirmuar kredinë për blerjen e televizorit në vlerën 99,900 lekë.

27. Për sa i takon llogarisë bankare të pagës së subjektit pranë Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2017, banka konfirmon llogari page në emër të z. Saimir Nazifi, me gjendje në datën 30.1.2017, në vlerën 39,454.4 lekë. Këtë llogari bankare subjekti nuk e ka deklaruar dhe me njoftimin e rezultateve iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim. Në prapësime subjekti ka sqaruar se kjo llogari rrjedhëse nuk është deklaruar prej tij për arsye administrative, me idenë se duke qenë se kjo ka qenë llogaria e pagës do të deklarohej nga institucioni nga vinte paga. Në përfundim, pasaktësia në deklarim nuk u vlerësua me ndonjë peshë domethënëse e me pasoja.

28. Subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me udhëtimet jashtë shtetit, qëllimet, destinacionet dhe pronarët e mjeteve. Në pyetësin nr. 2 subjekti ka paraqitur të dhënat e pronarëve të mjeteve, të cilat përputhen me të dhënat e sistemit AMF. Në prapësime subjekti ka sqaruar sërish në lidhje me disa saktësime që duhen bërë për sa i takon shpenzimeve të kryera nga ana e bashkëshortes së tij dhe vajzave kur kanë udhëtuar tek motra e tij E. N., për të cilën ka paraqitur edhe deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.6.2024 dhe fotokopjen e pasaportës së motrës dhe mbesës. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka depozituar dokumentacion ligjor në lidhje me udhëtimet në Itali te motra e tij dhe për këtë arsye pretendimet e tij për zbritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë në konsideratë në analizën e rishikuar financiare.

29. Nga të dhënat e SPAK-ut nuk kanë rezultuar të dhëna për ndonjë procedim penal në emër të shtetasve me të cilët subjekti ka udhëtuar. Subjekti ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje qëllimin e udhëtimeve, personat me të cilët ka qenë i shoqëruar, si dhe automjetet që ka përdorur. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shpenzimet e udhëtimit sipas deklarimeve të subjektit dhe standardit të Komisionit për të gjithë periudhën.

30. RNSH-ja ka informuar se rezultojnë disa kontrata noteriale me të dhëna për subjektin e rivlerësimit ose personat e lidhur, të cilat me kërkesë të Komisionit u vunë në dispozicion, si vijojnë:

30.1. Noterja A. K. në shkresën kthim përgjigjeje ka bashkëlidhur kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.7.2016, në të cilën palët shoqëria “****” sh.p.k. i shet shtetasit Sh. N. (babait të subjektit) apartamentin me sipërfaqe totale 65.86 m², me nr. pasurie ***, Tiranë, rruga “****”, në vlerën 30,000 euro. Bashkëlidhur certifikata e pronësisë, kartela e pasurisë në emër të shtetasit Sh. N., deklarata noteriale dhe 2 mandate bankare, të cilat konfirmojnë kryerjen e pagesës me bankë, njëra në datën 30.1.2006 në vlerën 16,000 euro dhe tjetra në datën 3.2.2006 në vlerën 14,000 euro.

30.2. Noterja A. B. ka vënë në dispozicion kontratat me të dhënat si më poshtë:

- Kontratë premtim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.11.2013, ku palët M. e L. K. (prindërit e bashkëshortes) i shesin shtetasve B. T. dhe A. H. apartamentin me nr. pasurie ***, me sipërfaqe totale 57.1 m², me adresë rruga “****”, Tiranë, kundrejt çmimit 6,500,000 lekë.

- Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.9.2014, ku palët kanë rënë dakord për shitjen e pasurisë si më sipër plus shtesa prej 35 m², e cila është në proces legalizimi dhe çmimi ka ndryshuar nga në 6,500,000 lekë 9,300,000 lekë që ishte shënuar çmimi në kontratën e premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.11.2013.

Për këtë pasuri subjekti ka deklaruar se të ardhurat nga shitja vjehri ia ka dhuruar motrës së bashkëshortes N. K.

30.3. Noterja V. P. ka vënë në dispozicion kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2017, midis palëve shoqëria “****”sh.p.k. dhe shtetasit M. K. (vjehri i subjektit) në cilësinë e blerësit për apartamentin me sip. 46.70 m², nr. pasurie ***, Durrës, rruga “****”, kundrejt çmimit 22,500 euro. Bashkëlidhur certifikata e pasurisë, harta treguese, kartelën e pasurisë në emër shoqërisë “****”sh.p.k. (trajtuar më sipër).

Deklarimet e pasurisë për personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit

31. Manjola Nazifi, bashkëshortja e subjektit, ka deklaruar:

- *Apartament banimi dhuruar me kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.02.2014, nga prindërit e mi: M. e L. K. . Kjo pronë është me sip. 67.6 m², e ndodhur në rrugën “****”, nd. ***, hyrja ***, ap. ***, z. k. ***, Tiranë (pallati e ka hyrjen nga rruga “****”). Ky apartament është blerë nga babai i M., shtetasi M. K., me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2006, nga shoqëria “****” sh.p.k., për shumën 21,632 euro (bashkëlidhur kontratat). Vlera: 21,632 euro. Zotërimi 100% (ky aset është trajtuar më lart në deklarin e subjektit).*

- *Disponoj në banesë një shumë prej 1,450,000 lekësh të përfituara nga kursimet nga pagat në vite të miat dhe të bashkëshortit. Vlera 1,450,000 lekë. Zotërimi 50% (kjo gjendje cash është trajtuar më lart në deklarin e subjektit).*

- M. N. ka deklaruar se ka përfituar shumë nga paga si mësuese e ciklit të ulët në shkollën “****”, Tiranë, nga viti 2013 (që nga momenti që bashkëshorti i saj si subjekt deklarues ka filluar detyrën si këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë) deri në dhjetor 2016 (momenti i deklarimit), e cila është në vlerë totale 1,680,000 lekë. Për të provuar deklarimin e saj ajo ka bashkëlidhur dokumentet provuese:

- ISSH-ja me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2017, konfirmon të ardhura nga punësimi për shtetasen M. N. nga fondacioni “****”.

- ILDKPKI-ja ka konstatuar se deklarimi dhe dokumentacioni i dorëzuar përputhen me përgjigjen e ISSH-së. ISSH-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2022, konfirmon punësimin për shtetasen M. N. për periudhën e deklaruar.

32. B. N., vajza e subjektit, ka deklaruar se është aktivizuar pranë Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) me kohë të pjesshme në asistim të veprimtarive të organizatës, me trajtim financiar për gjithë vitin 2016, ku ka përfituar pagesën në shumat 337 USD dhe 379 euro. Për të provuar deklarimin e saj ajo ka bashkëlidhur vërtetimin e pagës nr. *** prot., datë 26.1.2017, i lëshuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit për vitin 2016, në shumat 337 USD dhe 379 euro.

- ISSH-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2017, konfirmon se B. N. nga marsi i viti 2017 përfiton të ardhura nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit me pagë neto 30,753 lekë.

33. L. N., vajza e subjektit, ka deklaruar se ka përfituar shumë 2,000 euro nga gjyshi i saj Sh. N. për të kryer një trajnim në Gjermani (trajtuar më lart).

34. Nga hetimi nuk rezultuan pasuri në emër të tyre të ndryshme nga ato të deklaruara nga subjekti. Në pyetësonin standard subjekti ka deklaruar se vajzat e tij B. dhe L. N. kanë ndjekur studimet pranë shkollës jopublike “****”, ku bashkëshortja e tij ka qenë e punësuar si mësuese dhe për këtë arsye nuk është paguar tarifë për shkollimin. Subjektit iu kërkua të provojë me dokumentacion këtë deklarim. Në përgjigje të pyetësonit nr. 3 subjekti ka vënë në dispozicion vërtetimin e institucionit arsimor, me të cilin dokumentohet se bashkëshortja e subjektit nuk ka kryer pagesa shkollore për fëmijët e saj si punonjëse e institucionit.

Analiza financiare

35. Nga analiza e deklaratave të interesave pasurorë privatë/vjetorë, asaj *Vetting* dhe dokumentacionit të administruar, nga ana e Njësisë së Shërbimit Ligjor është kryer analiza financiare dhe në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë për shkak të balancës negative në shumë totale prej -7,264,137 lekësh për të gjithë periudhën e rivlerësimit, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën financiare që i është vënë subjektit në dispozicion me rezultatet e hetimit administrativ, analizë e cila mund të ndryshonte pas shqyrtimit të provave dhe shpjegimeve që subjekti do të paraqiste me ushtrimin e së drejtës për të kundërshtuar barrën e provës.

36. Sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, subjekti duhet të vërtetojë të kundërtën e këtij konstatimi. Në parashtrimet në lidhje me analizën financiare, subjekti ka kundërshtuar balancën negative, duke pretenduar se:

- Duhet të shtohen të ardhurat e bashkëshortes sipas vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Dibër me nr. *** prot., datë 27.12.2016, për vitet 1994 – 2003.

- Duhet të shtohen të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga viti 1982, pasi në analizën e Komisionit ato fillojnë të llogariten nga viti 1991.

- Duhet hequr likuiditeti i depozitës së përbashkët me vjehrrën në masën 3,106,069 lekë në vitin 2002, pasi ajo ka qenë në pronësi të familjes K.

- Duhet hequr vlera e apartamentit në rrugën “****” prej 2,675,943 lekësh në vitin 2006, sepse është pasuri e familjes K. dhe pas 10 vitesh i është dhuruar bashkëshortes së subjektit.

- Likuiditeti *cash* është në vlerën totale të deklaruar në vitin 2016, në ILDKPKI (1,700,000 lekë deri në vitin 2015) dhe më pas 2,000,000 lekë në deklaratën *Vetting* (deri në vitin 2016). Për arsye ligjore, subjekti ka mbajtur vetëm 1,450,000 lekë në shtëpi dhe shumën 550,000 lekë e ka depozituar në bankë, në janar 2017.

- Duhet zbritur shpenzimet TIMS për 460,007 lekë që u korrespondojnë shpenzimeve të kryera në masën 3,390 euro për vitet 2008, 2014 e 2015 për udhëtimet në Manzano tek motra e bashkëshortes së subjektit.

- Në lidhje me të ardhura të tjera të vjehrrit, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të lëshuar nga shtetasi A. K. me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.6.2024, si dhe një *statement* bankar të BKT-së për pagesat që ai ka përfituar nga një klinikë shëndetësore.

37. Në përfundim, subjekti pretendon se ka një vlerë prej 4,753,092 lekësh të ardhura më shumë se pasuria e vënë (të luajtshme e të paluajtshme) deri në janar 2017. Nga analiza financiare e përgjithshme e të ardhurave dhe shpenzimeve në vite, ai pretendon se rezulton me bilanc pozitiv, ndonëse ndonjë diferencë në ndonjë vit (gjatë llogaritjeve të 26 viteve, nga 1991 – 2016) mund të ketë ardhur për shkak të pasaktësive në deklarime që i ka plotësuar më vonë në ILDKPKI dhe në deklaratën *Vetting*, të cilat nuk duhet të merren në konsideratë, duke pasur parasysh dhe qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit tashmë se pasaktësitë në deklarime periodike, të pashoqëruara me mungesë finale të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

37.1. Në analizë të parashtrimeve, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të përmbysë tërësisht barrën e provës lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve. Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me të ardhurat nga paga të vërtetuara me dokument shkresor të bashkëshortes për periudhën 1994 – 2003. Në lidhje me pagat e subjektit duke nisur nga viti 1982, përveçse subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit të ardhurat e përfituara para viteve 1990, ato janë në vlera të papërfillshme dhe nuk kanë ndonjë efekt në analizën financiare¹⁰, qëndrim ky i mbajtur edhe nga Kolegji.

37.2. Në lidhje me pretendimin për zbritjen e shpenzimeve TIMS, Komisioni vlerëson se subjekti i ka provuar ato me dokumentacion provues dhe, për këtë arsye, i ka pasqyruar ndryshimet në analizën e rishikuar financiare. Në lidhje me pretendimet e tjera, si mospërfshirja e depozitës dyemërore me vjehrrën si pasuri e subjektit, mospërfshirja e vlerës së apartamentit dhuruar nga prindërit e bashkëshortes si pasuri e subjektit apo gjendjen e likuiditeteve në *cash*, vlerësimi i tyre është trajtuar gjerësisht më sipër në këtë vendim.

¹⁰ Shihni paragrafin 21.40 në vendimin nr. 15, datë 18.6.2021, të Kolegjit: “...*Periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend, që përkon me vitet 1991 – 1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar, që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshme, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend, që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendase hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992 – 1997, mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsion*”.

37.3. Po kështu, Komisioni konstaton se në mënyrë të gabuar, kur ka analizuar mundësitë e tij financiare, subjekti ka bërë një analizë kumulative dhe jo individuale për secilin vit. Kjo mënyrë bie në kundërshtim me metodologjinë e ndjekur nga Komisioni dhe Kolegji për personat deklarues.

37.4. Në përfundim të analizës së rishikuar financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë për shkak të balancës negative në shumën totale -2,098,174 lekë për të gjithë periudhën e rivlerësimit, e cila, pavarësisht pasaktësive dhe dyshimeve të ngritura nga Komisioni, arsyetuar hollësisht më sipër në këtë vendim, përbën shkak për penalizim.

37.5. Në përfundim të rivlerësimit të kriterit pasuror çmohet se subjekti ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, që sjell si pasojë marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

KONTROLLI I FIGURËS

38. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, AKSIK-ja (ish-DSIK) ka dërguar raportin¹¹ nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit Saimir Sh. Nazifi (H.), klasifikuar “Sekret”. Komisioni ka kërkuar që të dërgohet deklasifikimi i plotë për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, dërguar me raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, dhe në kthim përgjigje¹² AKSIK-ja e ka deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 29.2.2024, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të kimit të organizuar.

Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Saimir Sh. Nazifi (H.). Pasi është kërkuar përditësimi i të dhënave, ka rezultuar se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për subjektin Saimir Nazifi (H.).

SPAK-u¹³ ka informuar se në emër të shtetasit Saimir Sh. Nazifi nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës së AKSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

¹¹ Shihni raportin në dosjen e Komisionit.

¹² Shihni shkresën e dërguar nga AKSIK-ja me nr. *** prot., datë 4.3.2024, në dosjen e Komisionit.

¹³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2022, të SPAK-ut në dosjen e Komisionit.

39. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Saimir Nazifi bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor me nr. *** prot., datë 2.6.2023, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 23.6.2023; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

39.1. Sipas pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, është e përcaktuar se këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në:

- a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura;
- b) rezultatet e testimit në Shkollën e Magjistraturës.

Sipas shkresës nr. *** prot., datë 23.5.2018, përcjellë Komisionit nga Shkolla e Magjistraturës, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Saimir Nazifi, rezulton se ka marrë në total 130 (njëqind e tridhjetë) pikë.

Raporti për analizimin e aftësive profesionale kryer nga KLGJ-ja

40. Raporti për analizimin e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja është bazuar në: (i) formularin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) 5 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, të shtjelluara hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ; (iii) të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së, sipas të cilave nga analiza e të dhënave të rezultuara nga përmbajtja e formularit të vetëvlerësimit konstatohet se subjekti Saimir Nazifi ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në periudhën gusht 1996 deri në prill të vitit 2003 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Rrjedhimisht, për këtë subjekt, në Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk disponohen të dhëna për veprimtarinë e tij si gjyqtar për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016.

40.1. Nga verifikimi i akteve të dërguara nga KLGJ-ja në raportin e saj, rezulton se sipas shkresës së Gjykatës së Lartë, për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 për subjektin Saimir Nazifi nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

41. Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 84/2016 dhe ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit si më poshtë:

Për aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Dokumentet ligjore të vëzhguara tregojnë njohuritë ligjore të subjektit të rivlerësimit Saimir Nazifi në të Drejtën Civile, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ai ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit – ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë. Niveli i njohurive të tij ligjore konfirmohet edhe nga detyrat e tjera të rëndësishme që ai ka kryer ndër vite, siç është titulli “Avokat Shteti”, i fituar nga subjekti në datën 29.5.2009. Gjithashtu, këto njohuri konfirmohen edhe nga pjesëmarrja e tij në testimin profesional të subjekteve *ex officio* të organizuar në Shkollën e Magjistraturës. Sipas shkresës nr. *** prot., datë 23.5.2018, përcjellë Komisionit nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Vlerësimit Elektronik (faza e parë) dhe Komisioni i Vlerësimit të Testit Profesional (faza e dytë), ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë Saimir Nazifi rezulton se ka marrë në total 130 (njëqind e tridhjetë) pikë.

b) Arsyetimi ligjor

Nga pikëpamja formale, relacionet e hartuara nga ndihmësi ligjor Saimir Nazifi përmbajnë elementet e parashikuara në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. ***, datë 12.9.2014, të kryetarit të këtij Gjykate. Secili nga relacionet pasqyron rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet e ngritura në rekurs. Në drejtim të shkrimit ligjor, dokumentet në tërësinë e tyre janë të shkruara qartë dhe në mënyrë të kuptueshme e me strukturë të mirorganizuar, duke u evidentuar edhe mendimi i subjektit për pretendimet e ngritura. Vetë subjekti i rivlerësimit duket që përdor të njëjtën strukturë në hartimin e relacioneve.

Për aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Ai ka deklaruar se për periudhën janar 2014 – dhjetor 2016 ka përfunduar 675 çështje civile. Ndërsa nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Lartë, mbi bazën e të cilave u përzgjedhën dhe 5 dokumentet ligjore, rezulton se ndihmësi ligjor Saimir Nazifi ka hartuar relacione për 661 çështje me natyrë civile. Nga dokumentet ligjore të paraqitura prej vetë subjektit, si dhe nga dokumentet e përzgjedhura me short, nuk evidentohet asnjë e dhënë lidhur me kohën e përpilimit të relacioneve prej ndihmësit ligjor Saimir Nazifi. Në analizën e këtyre të dhënave, për të konkluduar mbi aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë, duhen evidentuar tre faktorë: (i) kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë; (ii) mungesa e të dhënave mbi kohën e caktimit të çështjeve për relativitet dhe e datës së përfundimit të relacionit nga ndihmësi ligjor, bën të pamundur llogaritjen e kohëzgjatjes së secilit relacion të ndihmësit ligjor, të përzgjedhur me short për vlerësim.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga të gjitha praktikat e administruara nuk ka dokumentim të veprimeve të kryera nga ndihmësi ligjor, me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie. Nga përmbajtja e 8 dokumenteve ligjore konstatohet se në çdo rast ndihmësi ligjor ka studiuar çështjen gjyqësore dhe e ka relatuar për çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, thelbin e analizës ligjore, si dhe shkaqet e rekursit. Këto veprime ai i ka materializuar në relacionin ligjor, ku ka plotësuar elementet procedurale të kërkuara në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. ***, datë 12.9.2014, të kryetarit të kësaj Gjykate.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga 5 dokumentet e përzgjedhura me short, rezulton se mendimi i ndihmësit ligjor është i përfshirë në dosjet fizike përkatëse, por referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata e Lartë dhe procesverbalit të shortit këto 5 dokumente u zgjedhën nga 661 dosjet që i kishin relacionet me emër të ndihmësit ligjor. Nga ana tjetër, duhet theksuar se në asnjë prej dokumenteve të paraqitura dhe relacioneve të shortuara nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre, pasi aktet nuk kanë datë dhe as nënshkrim të subjektit të rivlerësimit.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi ka deklaruar specializim në fushën e së drejtës, Master në shkencat juridiko-penale, të fituar në Fakultetin Juridik të universitetit “****” në Tiranë, në mars të vitit 2011. Subjekti ka bashkëlidhur gjithashtu certifikatën e titullit “Avokat”, të lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë më 31.3.2007. Për periudhën gusht 1996 – prill 2003, subjekti ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, ndërsa në periudhën prill 2003 – maj 2013 ka ushtruar detyrën e Avokatit të Shtetit në Zyrën Vendore Durrës, Zyrën Vendore Tiranë dhe Avokaturën e Përgjithshme. Në qershor të vitit 2013, ai është emëruar ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e ushtron edhe aktualisht. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk disponohen të dhëna mbi etikën e ndihmësit ligjor Saimir Nazifi. Por, me shkresën e Kancelares në detyrë të Gjykatës së Lartë, me nr. *** prot., datë 9.3.2023, është konfirmuar se për subjektin e rivlerësimit Saimir Nazifi përgjatë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 nuk është marrë asnjë masë disiplinore në ushtrimin e funksionit të tij si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

b) Integriteti

Nga dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi dhe nga 5 dokumentet e vëzhguara, nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 relacionet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Saimir Nazifi. Asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 relacionet e vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dokumentet e vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në të 8 dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit Saimir Nazifi me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore, e qartë, e plotë dhe e saktë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë, në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e tij me gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor apo me trupin gjykues të Gjykatës së Lartë. Nuk janë konstatuar vonesa në relativimin e çështjes që të ketë sjellë problematikë në gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit apo në seancën gjyqësore, kjo edhe për faktin se praktika e punës në këtë Gjykatë dhe veprimet e ndihmësit ligjor me dosjet përkatëse nuk evidentohen në regjistra për të matur parametrat e shpejtësisë dhe të sasisë në punë.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi ka deklaruar se tri vitet e fundit ka punuar në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, detyrë e cila konsiston në veprimtari ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë, duke përfshirë: përgatitjen e relacioneve për në dhomë këshillimi, përgatitjen e projektvendimeve për çështje gjyqësore civile, studimin e kërkesave dhe përfundimin e projektvendimeve për pezullim të ekzekutimit të vendimeve civile, për çështje gjyqësore civile që janë në shqyrtim të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ai punon. Ai i ka kushtuar rëndësi edhe formimit akademik, pasi në mars të vitit 2011 ka fituar titullin “Master” në shkencat juridiko-penale në Fakultetin Juridik të universitetit “****”, në Tiranë. Subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi, megjithëse nuk është subjekt që trajnohet nga Shkolla e Magjistraturës, ka deklaruar se ka qenë pjesëmarrës në dy aktivitete, të konfirmuara me fotokopje të certifikatave bashkëlidhur formularit, me temë “Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore”, më 14-16 mars 2001 dhe “Për rritjen e eficiencës në administrimin e drejtësisë”, organizuar nga Instituti ASSER në Hagë, Holandë, më 6-16 tetor 2013, çka lidhen me thellimin e njohurive të tij në fushën e të drejtave të njeriut dhe të gjykimeve civile.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

42. Tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLGJ-ja në raportin e saj.

43. Denoncimet nga publiku, në total 1 (një), me nr. *** prot., datë 18.7.2018, nga shtetasi F. Halil K..

43.1. Shtetasi F. H. K. denoncon gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, z. A. B., znj. M. F. dhe ndihmësin ligjor z. Saimir Nazifi, pasi sipas tij ka pasur parregullsi në gjykimin e çështjes me vendimin nr. ***, datë 7.12.2016, ku relatori i çështjes, gjyqtari A. B., si pasojë e ndikimit të ndihmësit të tij ligjor, z. Saimir Nazifi, ka ndryshuar qëndrim duke cenuar rëndë pozitën e tij profesionale dhe duke shkelur ligjin. Denoncuesi është shprehur se gjyqtari A. B. nuk e meriton të jetë në sistemin e drejtësisë, pasi vendimmarrjen e tij e vë në shërbim të krushqive, njohjeve etj., nën ndikimin e deputetit S. A. Ai ka ngritur dyshime se relacioni i parë pozitiv është hequr dhe është zëvendësuar me relacionin që gjendet në dosje, pasi ndihmësi ligjor Saimir Nazifi ka lidhje krushqie me familjen S. (motra e tij, ish-ndihmësja ligjore e gjyqtarit A. B. është nuse tek familja S., aty ku i padituri S. A. ka dhënë motrën). Denoncuesi nuk ka paraqitur ndonjë dokument bashkëlidhur. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me pretendimet e ngritura në drejtim të tij në këtë denoncim.

43.2. Në parashtrimet e tij, subjekti i ka kundërshtuar pretendimet e denoncuesit, duke sqaruar praktikën që ndiqej më parë në Gjykatën e Lartë, në kohën kur është gjykuar çështja me nr. *** dhe datë regjistrimi 16.4.2013. Subjekti shpjegoi se kjo çështje është gjykuar fillimisht në dhomë këshillimi, në datën 15.12.2015, me relator gjyqtarin A. Th. dhe është vendosur nga Kolegji “Kalimi i çështjes në seancë gjyqësore”. Relacionin për gjyqtarin A. Th. e ka përgatitur njëri prej dy këshilltarëve që ai ka pasur në atë kohë, D. K. dhe A. B. Në momentin që vendimi i kalimit në seancë gjyqësore hidhej në sistemin e brendshëm, automatikisht caktohej gjyqtari relator, që në rastin konkret ka qenë A. B., në ndryshim nga sot që trupi gjykues që e kalon çështjen nga dhoma e këshillimit në seancë gjyqësore është i njëjti trup, i pandryshuar. Në momentin që kjo çështje do të caktohej për gjykim sipas radhës, trupi gjykues caktonte datën dhe vazhdonte me shqyrtimin e çështjes. Këshilltari ligjor i gjyqtarit që merrte dosjen nuk kryente asnjë veprim, pasi relacioni ishte i përgatitur më parë nga këshilltarët e tjerë, të cilët e kishin pasur në momentin e parë të shqyrtimit. Ndaj, për këtë çështje subjekti nuk ka përgatitur asnjë relacion, pasi e ka përgatitur

këshilltari i gjyqtarit A. Th. Subjekti ka sqaruar se nisur nga rrethanat konkrete, në asnjë moment ai në cilësinë e ndihmësit ligjor nuk ka qenë në situatën e konfliktit të interesit, në kushtet kur nuk ka qenë pjesë e procesit vendimmarrës, por edhe ndihmës në lidhje me këtë mosmarrëveshje gjyqësore, siç ka rezultuar edhe nga provat e paraqitura nga ana e tij, ku në cilësinë e ndihmësit ligjor ai nuk ka dhënë asnjë mendim juridik në lidhje me këtë çështje, pasi nuk ka qenë pjesë e procesit. Subjekti ka sqaruar se denoncimi i ardhur në rastin konkret është mbështetur në supozime dhe në asnjë rrethanë apo fakt konkret, i cili krijon minimalisht dyshimin e arsyeshëm në lidhje me veprime aktive nga ana e tij në dëm të palës denoncuese. Përkundrazi, roli dhe pozicioni i tij në cilësinë e ndihmësit ligjor ka qenë tërësisht pasiv dhe në asnjë moment i përfshirë në këtë procedurë gjyqësore. Në mbështetje të sqarimeve, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.6.2024, nga Gjykata e Lartë në lidhje me këtë dosje, si dhe të gjithë praktikën e fashikullit të gjykimit në Gjykatën e Lartë.

43.3. Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, Komisioni nuk konstaton problematika në drejtim të aftësive profesionale.

44. Në përfundim, sipas ligjit nr. 96/2016, për subjektin është vlerësuar se: (i) ka treguar aftësi të mira profesionale; (ii) ka treguar aftësi të mira organizative (iii) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale; (iv) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional. Për rrjedhojë, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

SEANCA DËGJIMORE

45. Në datën 24.6.2024, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Saimir Nazifi, në përfundim të së cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Saimir Nazifi dhe shpalli vendimin në seancën e datës 25.6.2024, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

46. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë i gatshëm për t’u përgjigjur brenda afateve të caktuara. Por, ka pasur raste që nuk ka dhënë shpjegime ose ka dhënë shpjegime/deklarime jo në mënyrë shteruese dhe jo në koherencë me deklaratimet e vetë subjektit apo aktet shkresore të administruara, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi nuk ka arritur nivel kualifikues për sa i takon kriterit të pasurisë.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Saimir Nazifi, ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 25.6.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Firdes SHULI
Relatore

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana